


Deloitte.

Nisma për Transparencë në Industrinë Nxjerrëse në Shqipëri Raporti për vitin 2012

Nëntor 2014



Përmbajtja

Përmbledhje ekzekutive	4
1. Hyrje	8
2. Pamje e përgjithshme e industrisë nxjerrëse në Shqipëri	11
3. Pamje e përgjithshme e flukseve të raportuara dhe e shoqërive raportuese	37
4. Qasja, metodologjia dhe puna e kryer	38
5. Përmbledhja e rakordimit	41
6. Rezultatet e rakordimit	42
7. Komente dhe rekomandime	51
Fjalor dhe shkurtime	55
Shtojca 1: Rakordimi në detaje për sektorin e naftës dhe gazit	56
Shtojca 2: Rakordimi në detaje për sektorin mineralar	58

Grupi Ndërinstitucional i Punës
Ministria e Energjisë dhe Industrisë
Blv. "Dëshmorët e Kombit"
Tiranë, Shqipëri

Raport mbi gjetjet faktike – mbledhja dhe rakordimi i flukseve të parasë

Ky raport përmbledh rezultatet e rakordimit të fluksit të parasë nga aktivitetet e sektorit të naftës dhe gazit dhe sektorit mineral si pjesë e zbatimit të Nismës për Transparencë në Industrinë Nxjerrëse ("NTIN" ose "EITI") në Shqipëri.

Raporti përbëhet nga shtatë kapituj. Kapitulli 1 përshkruan historikun dhe qëllimin e raportimit. Kapitulli 2 paraqet informacion mbi rregullimin dhe veprimtarinë e industrisë. Proçedurat e raportimit, përpilimit dhe rakordimit janë paraqitur në kapitujt 3 dhe 4. Përmbledhja e rakordimit është paraqitur në kapitullin 5. Në kapitullin 6, është paraqitur nivel të përmbledhur përpilimi dhe rakordimi i pagesave. Komentet dhe rekomandimet nga rakordimi i këtij viti janë përmbledhur në kapitullin 7. Shumat e raportuara, të detajuara për çdo shoqëri, janë përfshirë si shtojca në këtë raport. Shumat në raport janë paraqitur në mijë Lek, përveç se kur shprehet ndryshe.

Ne kemi kryer punën tonë në përputhje me Standardin Ndërkombëtar për Shërbimet e Lidhura ("SNSL" ose "ISRS") 4400 "Angazhime sipas proçedurave të rëna dakord në lidhje me Informacionin Financiar", publikuar nga Federata Ndërkombëtare e Kontabilistëve ("FNK" ose "IFAC").

Proçedurat tona janë listuar në seksionin 4.5. Gjetjet tona janë paraqitur në kapitullin 6 të këtij raporti dhe në shtojcat e tij. Informacioni i paraqitur në Kapitullin 1 dhe Kapitullin 2 është përgatitur nga EITI Shqipëri në bashkëpunim me Ministrinë e Energjisë dhe Industrisë, Agjencinë Kombëtare të Burimeve Natyrore në Shqipëri, dhe Shërbimin Gjeologjik Shqiptar. Ne nuk kemi kryer proçedura për të verifikuar plotësinë dhe saktësinë e informacionit të paraqitur në këto kapituj.

Proçedurat e rëna dakord nuk përbëjnë auditim apo rishikim sipas Standardeve Ndërkombëtare të Auditimit apo Standardeve Ndërkombëtare për Angazhimet e Rishikimit, si rrjedhojë ne nuk shprehim asnjë siguri mbi pagesat e raportuara nga shoqëritë e liçensuara apo institucionet qeveritare.

Informacioni i paraqitur në raportin tonë, ose informacioni i dhënë nga shoqëritë e liçensuara apo institucionet qeveritare, nuk ka qenë objekt i proçedurave të kontrollit apo verifikimit, përveçse kur në raport shprehet ndryshe. Nëse do kishim kryer proçedura shtesë, auditim apo rishikim sipas Standardeve Ndërkombëtare të Auditimit apo Standardeve Ndërkombëtare për Angazhimet e Rishikimit, mund të ishin identifikuar apo raportuar çështje të tjera.

Qëllimi i këtij raporti është të përmirësojë transparencën në industrinë nxjerrëse. Proçedurat tona nuk janë hartuar për të identifikuar mashtrime ose gabime të bëra nga shoqëritë e liçensuara dhe institucionet qeveritare.

Deloitte Audit Albania sh.p.k.

21 nëntor 2014

Tiranë, Shqipëri

Përmbledhje ekzekutive

Kjo përmbledhje paraqet faktet kryesore mbi industrinë nxjerrëse në Shqipëri dhe gjetjet nga rakordimi i pagesave të kryera nga Shoqëritë e naftës, gazit dhe mineraleve me deklaratimet e Shtetit dhe Shoqërisë së zotëruara nga Shteti, Albpetrol.

Shqipëria është një ndër 31 vendet **anëtare të Nismës për Transparencë në Industrinë Nxjerrëse**.

Në zbatim të kësaj nisme **Qeveria e Shqipërisë publikon këtë raport informues** mbi aktivitetin e nxjerrjes së naftës, gazit dhe mineraleve, kontributin e kësaj industrie në Buxhetin e Shtetit dhe përdorimi i të ardhurave që vjel Shteti nga kjo industri me qëllim **promovimin e transparencës** për të parandaluar korrupsionin, si dhe **sensibilizimin e qytetarëve** për të kërkuar përdorimin e drejtë të të ardhurave nga shfrytëzimi i burimeve natyrore në vend.

I. Vështrim mbi industrinë nxjerrëse

Tabela 1 – Disa të dhëna kryesore për industrinë nxjerrëse

në miliard Lek, përveçse kur shprehet ndryshe

	2012	2011
Prodhimi i naftës dhe gazit	50.3	47.9
Prodhimi mineralar	15.5	22.8
Prodhimi total	65.8	70.7
Kontributi në PBB	5.6%	4.3%
Kontributi në Buxhetin e Shtetit		
Sektori hidrokarbur	7.1	4.7
Sektori mineralar	1.3	1.4
Kontributi total	8.3	6.0
Kontributi total në %	2.5%	1.8%

AKBN raportoi prodhimin total të naftës dhe mineraleve të tjera në shumën **65.8 miliard Lek në vitin 2012 dhe 70.7 miliard Lek në vitin 2011**.

Nafta zinte **76%** të prodhimit total në vitin **2012** dhe **68%** në vitin **2011**.

Rreth **85% e naftës** u prodhua nga puset në **Patos-Marinëz**.

Prodhimi i kromit zinte rreth **62% të prodhimit mineralar në 2012** dhe **66% në 2011**.

Rreth **58% e kromit** në vitin 2012 dhe **70% e kromit** në vitin 2011 u prodhua në rrethin e **Bulqizës**.

Sipas INSTAT, prodhimi nga industria nxjerrëse e naftës, gazit dhe mineraleve përbente rreth **5.6% të prodhimit të brendshëm bruto në vitin 2012** dhe **4.3% në vitin 2011**.

Kontributi i industrisë nxjerrëse **në punësim** mbetet modest. Sipas AKBN, shoqëritë e licensuara në nxjerrjen e naftës, gazit dhe mineraleve e tjera punësojnë së bashku **më pak se 1%** të totalit të të punësuarve në vend.

Figura 1 – Flukset e parasë gjeneruar nga industria nxjerrëse




Figura 1 më sipër paraqet një pamje të përgjithshme të flukseve të parasë gjeneruar nga industria nxjerrëse dhe shpërndarjen e tyre ndërmjet Buxhetit të Shtetit dhe shoqërisë Albpetrol.

Të ardhurat e gjeneruara nga industria nxjerrëse nga ndarja e prodhimit të naftës, renta minerare, tatimi mbi fitimin dhe bonuset e nënshkrimit) janë në total **11,860 milion Lek**. Këto të ardhura përfshijnë prodhimin e naftës dhe bonuset në vlerën **5,415 milion Lek** të mbledhur nga Albpetrol për licencat e prodhimit nën administrimin e tij. Albpetrol, si shoqëri e licencuar, **derdhi në Buxhetin e Shtetit** rentën minerare, tatimin mbi fitimin dhe dividendin në shumën **1,901 milion Lek** në total. Pagesat në shumën **8,346 milion Lek** ose 70% e flukseve totale të parasë gjeneruar nga industria nxjerrëse, janë regjistruar në **Buxhetin e Shtetit**. Këto pagesa kontribuan me **2.5% në totalin e të ardhurave** të Buxhetit të Shtetit në vitin **2012** (2011: 1.8%).

Spektori privat i naftës dhe gazit gjeneroi pjesën më të madhe të kontributit në Buxhetin e Shtetit në vlerën **5,180 milion Lek** ose **62% e pagesave ndaj Buxhetit të Shtetit nga industria nxjerrëse**. Albpetrol dhe sektori minerar gjeneruan përkatësisht 23% dhe 15% të këtij kontributi.

Në vitin 2012, pagesat e kryera ndaj Albpetrol nga shoqëritë e naftës dhe gazit në përputhje me marrëveshjet hidrokarbure ishin **5,415 milion Lek** (2011: 3.5 miliardë Lek). **Nëse këto pagesa do të ishin regjistruar direkt në Buxhetin e Shtetit, kontributi i industrisë nxjerrëse në Buxhet do të ishte përkatësisht 4.1% në vitin 2012 dhe 2.9% në vitin 2011.**

Tabela 2 – Renta minerare paguar nga industria nxjerrëse

në miliard Lek, përveçse kur shprehet ndryshe

	2012	2011
Spektori i naftës dhe gazit	6.5	4.3
Spektori minerar	0.7	0.6
Renta në total	7.2	4.9
Kontributi në Buxhetin Shtetit	2.2%	1.5%
Shpërndarja e rentës minerare në NjQV-të prodhuese		
Spektori i naftës dhe gazit	0.04	-
Spektori minerar	-	-
Renta shpërndarë në %	0.6%	0%

Ministria e Financave raportoi se nuk është bërë asnjë transferim rente drejt NjQV-ve gjatë vitit 2011. Në vitin 2012, transferimet për rentën minerare arritën shumën 41.7 milion Lek që përbën 0.6% të rentës së mbledhur në total ose 2.3% e totalit të rentës se tranferueshme në përputhje me Ligjin për taksat kombëtare. Sipas Ministrisë së Financave, të ardhurat nga renta minerare në vitin 2011 dhe 2012 ishin regjistruar në buxhetin e Shtetit në grup dhe nuk janë mbajtur regjistrime të sakta mbi rentën e gjeneruar nga secila NjQV.

II. Rakordimi për vitin 2012

Përzgjedhja e shoqërive raportuese

Të gjitha shoqëritë që operonin një liçensë në kërkim-zbulim për naftën, gazin dhe mineralet dhe një liçensë prodhimi në naftë dhe gaz, u përzgjedhën të raportonin pagesat sipas Standartit EITI. Kështu, **fluksi i parasë së rakorduar për sektorin e naftës dhe gazit përfaqëson 100% të fluksit të parasë kontribuar** në total nga ky sektor për llojet të ardhurave përsfshirë në këtë rakordim.

Për shkak të numrit të madh të shoqërive prodhuese me shkallë të vogël aktiviteti, në sektorin minerar u aplikuan kritere të caktuara materialiteti ndaj xhiros dhe prodhimit vjetor me qëllim përzgjedhjen e prodhuesve më të mëdhenj. Përzgjedhja rezultoi me **69 shoqëri minerare**, të cilat bazuar në të dhënat e AKBN, përbënin **77.1% të vlerës së prodhimit**.

Numri total i të liçensuarve të përzgjedhur për procesin e rakordimit ishte **78, dhe përshinte nga 8 shoqëri naftë, Albpetrol dhe 69 shoqëri minerare**. Në datën e këtij raporti, **74 nga 78 të liçensuar raportuan gjithsej pagesat** e kryera ndaj Shtetit dhe shoqërisë Albpetrol sipas tipeve të kërkuara të të ardhurave.

Deloitte u angazhua në rakordimin e flukseve të parasë raportuar nga shoqëritë e liçensuara dhe institucionet qeveritare me qëllim identifikimin dhe qartësimin e ndonjë mospërputhje të mundshme midis raportimeve. Të gjitha mospërputhjet e identifikuar fillimisht, u analizuan më tej për t'u rakorduar dhe shpjeguar.

Pjesa më e madhe e mospërputhjeve u shpjegua nëpërmjet punës së rakordimit. Mospërputhjet e shpjeguara rezultuan kryesisht për shkak të shumave të paraportuara fillimisht ose gabimeve në raportim.

Shoqëritë e liçensuara dhe institucionet shtetërore mbledhëse të pagesave kanë qenë mjaft bashkëpunues në zgjidhjen e këtyre mospërputhjeve. Megjithatë, numëri i madh i mospërputhjeve të identifikuar tregon që ka vend për përmirësimin e raportimeve përkatëse dhe caktimin e një procesi për garantimin e cilësisë dhe sigurimin në lidhje me plotësinë dhe saktësinë e të dhënave.

Komentet dhe rekomandimet janë paraqitur në kapitullin 7 të këtij raporti.

Deri në datën e këtij Raporti **flukset e parasë u rakorduan në 99%** e flukseve të raportuara nga të liçensuarit dhe Shteti ose or të liçensuarit dhe Albpetrol.

Kapitujt 5 dhe 6 paraqesin rakordimin në një nivel të agreguar. Rakordimi për çdo shoqëri është paraqitur në shtojcat e këtij raporti. Tabela 3 dhe 4 më poshtë paraqet një përmbledhje të rakordimit të fluksit të parasë.

Tabela 3 Përmbledhja e rakordimit të pagesave ndaj Buxhetit të Shtetit

Pagesat e agreguara	Shuma e korigjuar në million Lek			Shuma e korigjuar në million USD*		
	Të liçensuarit	Qeveria	Mospërputhja	Të liçensuarit	Qeveria	Mospërputhja
Sektori i naftës dhe gazit	6,927	6,927	-	65.0	65.0	-
Sektori minerar	1,004	1,021	(17)	9.4	9.6	(0.2)
Albpetrol	1,889	1,901	(13)	17.7	17.8	(0.1)
Totali	9,819	9,849	(29)	92.1	92.4	(0.3)

Tabela 4 Përmbledhja e rakordimit të pagesave ndaj Albpetrol

Pagesat e agreguara	Shuma e korigjuar in Lek million			Shuma e korigjuar in USD million*		
	Të liçensuarit	Albpetrol	Mospërputhja	Të liçensuarit	Albpetrol	Mospërputhja
Sektori i naftës dhe gazit	5,478	5,415	63	51.4	50.8	0.6
Totali	5,478	5,415	63	51.4	50.8	0.6

(*) Shumat janë konvertuar në USD me kursin mesatar USD / Lek të Bankes së Shqipërisë për vitin 2012, ku 1 USD = 106.57 Lek.

1. Hyrje

Ky raport është raporti i katërt i Nismës për Transparencë në Industrinë Nxjerrëse dhe mbulon periudhën nga 1 janar 2012 deri në 31 dhjetor 2012.

1.1 Çfarë është EITI?

Nisma për Transparencë në Industrinë Nxjerrëse ("NTIN" ose EITI") është një koalicion vullnetar ndërkombëtar i qeverive, shoqërive që operojnë në këtë industri dhe organizatave të shoqërisë civile të angazhuara në menaxhimin dhe përdorimin e burimeve natyrore, të tilla si nafta, gazi dhe minerale të tjera (shih gjithashtu: www.eiti.org). EITI ka për qëllim promovimin e transparencës për të parandaluar korrupsionin, si dhe t'i sigurojë qytetarëve një bazë për të kërkuar përdorimin e drejtë të të ardhurave. Gjithashtu, pritet që transparenca të kontribuojë pozitivisht në rritjen e investimeve në këtë sektor.

Krahas përpjekjeve të tjera për të përmirësuar transparencën në menaxhimin e buxhetit të Shtetit, EITI fillon një proces ku Shteti do të jape llogari para qytetarëve për përdorimin e këtyre të ardhurave.

A country's natural resources belong to its citizens. Citizens should have the right to see what their government is receiving from these resources. However, in too many countries this information is not publicly available.

Nisma për Transparencë në Industrinë Nxjerrëse rregullohet nëpërmjet një standarti ndërkombëtar, "Standarti EITI" që siguron më shumë transparence rreth menaxhimit të burimeve të naftës, gazit dhe mineraleve të tjera. Standarti EITI zëvendësoi rregullat e mëparshme EITI në korrik 2013.

Standarti EITI është hartuar nga një koalicion ndërkombëtar i qeverive, shoqërive që operojnë në këtë industri dhe organizatave të shoqërisë civile, që vepron

njëkohësisht edhe si mbikqyrës të zbatimit të tij. Ai bazohet në besimin se përdorimi i matur i burimeve natyrore sjell rritje ekonomike, zhvillimi të qëndrueshëm dhe reduktim të varfërisë në vendet e pasura me burime natyrore.

Sipas këtij standarti, shoqëritë publikojnë atë që paguajnë dhe shtetet publikojnë atë që arkëtojnë. Këto pagesa paraqiten në raportin vjetor të EITI-t, i cili duhet të jetë gjithëpërfshirës dhe do të promovohet në mënyrë aktive që t'i lejojë qytetarët të kuptojnë se sa mbledh Shteti nga përdorimi i burimeve natyrore të vendit dhe të nxisë ata të kërkojnë një përdorim të drejtë të këtyre të ardhurave.

1.2 EITI në Shqipëri

Nisma për Transparencë në Industrinë Nxjerrëse në Shqipëri (AlbEITI, www.albeiti.org) u themelua në vitin 2009 nga Shteti shqiptar me qëllimin e promovimit të qeverisjes së mirë të burimeve natyrore nëpërmjet zbatimit të kriterëve dhe parimeve ndërkombëtare të Nismës për Transparencë në Industrinë Nxjerrëse. Shqipëria u bashkua si kandidat e EITI në maj 2009 dhe fitoi statusin e plotë të anëtarësisë në maj 2013. Tre raporte vjetore janë publikuar përkatësisht për vitet 2009, 2010 dhe 2011. Ky është raporti i katërt vjetor që mbulon periudhën nga 1 janar 2012 në 31 dhjetor 2012.

Proçesi në Shqipëri mbikqyret nga Grupi Ndërinstitucional i Punës ("MSG" ose "Grupi Shqiptar i Punës"), rregulluar nga Urdhëri nr. 71, datë 21 korrik 2011, kryesuar nga zv. Ministri i Ministrisë së Energjisë dhe Industrisë dhe i përbërë nga disa grupe interesi të EITI-t duke përfshirë Qeverinë, shoqëritë nxjerrëse, shoqërinë civile etj. Grupi Shqiptar i Punës është organi vendimmarrës dhe mbikqyrësi i zbatimit të EITI-t në Shqipëri. Sekretariati i EITI-t në Shqipëri ("AlbEITI") mbështetet Grupin Shqiptar të Punës në përmbushjen e detyrave të tij.

1.3 Grupi Shqiptar i Punës

Qeveria e Shqipërisë

- | | |
|------------------------|---|
| ▪ Z. Ilir Bejtja | Zv. Ministër i Energjisë dhe Industrisë – Kryetar |
| ▪ Z. Dritan Spahiu | Ministria e Energjisë dhe Industrisë |
| ▪ Z. Mehmet Hasalami | Ministria e Energjisë dhe Industrisë |
| ▪ Znj. Arjana Dymishi, | Ministria e Financave |
| ▪ Znj. Ermonela Xhafa | Ministria e Drejtësisë |
| ▪ Znj. Alketa Knuti | Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve |
| ▪ Z. Bislim Boshnjaku | Sherbimi Gjeologjik Shqiptar |
| ▪ Z. Jorgo Thanas | Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore |
| ▪ Z. Pandi Duro | Administrata Doganore Shqiptare |

Organizatrat e Shoqërisë Civile

- Z. Ilir Aliaj Qendra për Zhvillimin dhe Demokratizimin e Institucioneve
- Znj. Anila Hajnaj Qendra Shqiptare për Zhvillimin dhe Integrim
- Z. Sami Nezaj Qendra për Transparencë dhe Informim të Hapur
- Z. Erald Kapri Youth Media Albania
- Z. Fatbardh Zeneli Qendra Shqiptare për të Drejtat Ndërkombëtare

Grupet e interesit

- Z. Omer Dashi Bankers Petroleum
- Z. Saimir Boka Albchrome
- Z. Perparim Alikaj FIAA
- Z. Fatbardh Ademi Stream Oil and Gas
- Z. Dritan Dervishaj Antea Cement
- Znj. Migela Xhani Beralb
- Znj. Andia Beluli Petromanas

1.4 Raportimi vjetor

Sipas standartit EITI, të licënuarit dhe institucionet qeveritare do të raportojnë përkatësisht pagesat e kryera dhe të ardhurat e arkëtuara çdo vit dhe të gjitha këto do të rakordohen nga një administrator i pavarur në kuadrin e zbatimit të vazhdueshëm të EITI. Në këtë kontekst, MSG dhe AlBEITI u kërkuan palëve të mëposhtme të raportojnë të gjitha pagesat e kryera ndaj Shtetit shqiptar:

- të gjitha shoqëritë e licënuara që operojnë në kërkimin e naftës, gazit dhe mineraleve,
- të gjitha shoqëritë e licënuara në prodhimin e naftës dhe gazit, dhe
- shoqëritë më të mëdha në sektorin mineral me vlerë prodhim mbi 750 mijë dollarë amerikan.

Gjithashtu, MSG dhe AlBEITI i kërkuan institucioneve qeveritare përgjegjëse të raportojnë të ardhura që kanë arkëtuar nga këto shoqëri.

Raportimi EITI në Shqipëri për sektorin mineral rregullohet nëpërmjet Ligjit nr. 10304 "Për sektorin mineral në Republikën e Shqipërisë", datë 15 korrik 2010, i cili detyron të gjitha shoqëritë minerare të raportojnë sipas standardit EITI. Sektori i hidrokarbureve ka pranuar vullnetarisht të raportojë sipas EITI-t nëpërmjet Memorandumit të Mirëkuptimit (MM) të nënshkruar ndërmjet Sekretariatit AlBEITI dhe të gjitha shoqërive që operojnë në sektorin e hidrokarbureve.

Sipas kërkesave të standardit të ri EITI, EITI Shqipëri hartoi informacionin kontekstual rreth sektorit nxjerrës në Shqipëri. Për këtë qëllim, MSG dhe AlBEITI i kërkuan Institutit të Statistikave (INSTAT), rregullatorëve të industrisë dhe agjentëve tatimorë t'i japin ALBEITI-t të dhëna makroekonomike, të dhëna mbi prodhimin, eksportet dhe të ardhurat e mbledhura nga industria nxjerrëse.

Më 2 maj 2014, MSG caktoi Deloitte Albania Sh.p.k. administrator të pavarur sipas kontratës datë 2 maj 2014. Roli i Administratorit është:

- Të mbledhë raportimet nga shoqëritë e licënuara dhe institucionet qeveritare;
- Të përpilojë raportin dhe me sa është e mundur të zgjidhë mospërputhjet;
- Të përgatisë dhe publikojë një raport që përfshin pagesat dhe të ardhurat e rakorduara, mospërputhjet dhe çështje të tjera të rëndësishme për të kuptuar pagesat dhe të ardhurat nga aktiviteti hidrokarbur dhe ai mineral;
- Të japë rekomandime për të përmirësuar procesin.

1.5 Falënderime

Shprehim falënderimet tona të sinqerta për Ministrinë e Energjisë dhe Industrisë, Grupin Shqiptar të Punës dhe Sekretariatit AlBEITI, të cilët na kanë ndihmuar në marrjen në kohë të përgjigjeve nga Shteti dhe shoqëritë pjesëmarrëse. Një falënderim i veçantë shkon për Z. Dritan Spahiun dhe Z. Dael Dervishin për mbështetjen për përgatitjen e një informacioni kontekstual gjithëpërfshirës mbi sektorin nxjerrës në Shqipëri.

2. Pamje e përgjithshme e industrisë nxjerrëse në Shqipëri

Informacioni i përfshirë në këtë kapitull është siguruar nga Sekretariati EITI në Shqipëri në bashkëpunim me Ministrinë e Energjisë dhe Industrisë, Agjencinë Kombëtare të Burimeve Natyrore, dhe Shërbimin Gjeologjik Shqiptar.

Administratori i pavaruar nuk ka kryer procedura verifikuese për të vërtetuar plotësinë dhe saktësinë e informacionit që paraqitet në këtë kapitull.



2.1 Kuadri ligjor që rregullon menaxhimin e burimeve natyrore

Ministria e Energjisë dhe Industrisë ("MEI") është Ministria përgjegjëse për hartimin e politikave publike për menaxhimin e energjisë dhe burimeve natyrore si dhe monitorimin e zbatimit të këtij legjislacioni. MEI është përgjegjëse për dhënien e licensave të kërkimit dhe prodhimit në sektorin e naftës, gazit dhe minierave.

Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore ("AKBN") dhe Shërbimi Gjeologjik Shqiptar ("SHGJSH") mbështesin MEI-n në procedurat para dhe pas liçensimit, përkatësisht AKBN për liçensat e prodhimit dhe SHGJSH për liçensat e kërkimit. Procedurat para-liçensimit përfshijnë: promovimin e zonave të pashfrytëzuara, udhëzimin e operatorëve potencial mbi procesin, verifikimin teknik i planit të propozuar të prodhimit dhe negocimin e planit të investimeve dhe kushteve të tjera. Procedurat e pas-liçensimit përfshijnë monitorimin e aktivitetit të të liçensuarve përmes raportimeve periodike nga të liçensuarit dhe monitorimin në terren.

2.1.1. Kërkimi, zhvillimi, dhe prodhimi i naftës dhe gazit

Kërkimi, zhvillimi dhe prodhimi i naftës dhe gazit në Shqipëri rregullohen nga Ligji nr. 7746 "Për hidrokarburet (Kërkim dhe Prodhim)" datë 28 korrik 1993 ("Ligji i hidrokarbureve"). Pas miratimit fillestar, ligji është ndryshuar nga ligjet me numër 7853 (29 korrik 1994), 7811 (12 prill 1994) dhe 9975 (28 korrik 2008)¹.

Në ligjin për hidrokarburet, shkruhet shprehimisht se të gjitha depozitat e naftës që ndodhen në gjendjen e tyre natyrore në shtresat tokësore brenda juridiksionit të Shqipërisë, janë pronë ekskluzive e Shtetit shqiptar. Ligji lejon Ministrinë e Energjisë dhe Industrisë të nënshkruajë Marrëveshje Hidrokarbure, sipas së cilës shoqërisë së naftës mund t'i jepet e drejta ekskluzive për të kërkuar dhe prodhuar naftë dhe gaz për një periudhë kohe të kufizuar.

Qeveria e Shqipërisë është aktualisht duke rishikuar ligjin mbi hidrokarburet. Këto rishikime paraprake nuk ishin publikuar deri në datën e këtij Raporti.

2.1.2 Albpetrol – Shoqëria e naftës e zotëruar nga Qeveria Shqiptare

Albpetrol Sh. A. është Shoqëria e zotëruar nga Qeveria Shqiptare që vepron në zhvillimin, prodhimin dhe tregtimin e naftës bruto dhe e gazit. Albpetrol Sh.a. ("Albpetrol") u themelua më 20 mars 1993, me aksionar të vetëm Shtetin Shqiptar, përfaqësuar nga Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Tregtisë dhe Sipërmarrjes.

Në vitin 1993, Ligji për Hidrokarburet i dha nën **administrim Albpetrolit të gjitha fushat naftë-mbajtëse ekzistuese në Shqipëri dhe katër blloqe të kërkimit në zonat e Dumresë, Panajës, Velçes dhe Delvinës**. Kufijtë e veprimit dhe të drejtat e Albpetrolit për kërkimin dhe prodhimin u përcaktuan në një marrëveshje të veçantë të miratuar më 26 korrik 1993 ("Marrëveshja e Albpetrolit"). Me të njëjtat kushte, me Vendim të Këshillit të Ministrave (VKM) nr. 279, datë 12 prill 2012, Albpetrolit iu dhanë **dhe blloqet e kërkimit 1, 5, 6, 7 dhe 8**.

Aktiviteti fillestar i Alpetrol përfshinte kërkimin, prodhimin, rafinimin, marketingut dhe shitjen, si dhe shërbimet e naftës dhe gazit. Në vitin 1998, si rrjedhojë e procesit të ristrukturimit, Albpetrol u nda në tri kompanitë shtetërore si më poshtë:

- Albpetrol Sh.a. ("Albpetrol"), që mbajti aktivitetin kërkimit dhe prodhimit të naftës dhe gazit, dhe gjithashtu trashëgoi administrimin të gjitha liçensat e dhëna para kësaj date;
- ARMO Sh.a. që mbajti rafinimin dhe marketingun dhe shitjet e naftës; dhe
- Servcom, që mbajti shërbimeve të naftës.

Me anë të ligjit nr. 10490, datë 15 dhjetor 2011, Kuvendi i Shqipërisë vendosi për privatizimin e Albpetrol. Pas këtij vendimi, Ligji "Për hidrokarburet" u ndryshua në vitin 2012 me Ligjin nr. 31/2012 duke ripërcaktuar pozicionin e Albpetrol si një shoqëri tregtare.

Rrjedhimisht, të drejtat e kërkimit dhe prodhimit dhënë Albpetrol Sh.a. si i liçensuar parësor, u bënë subjekt i kushteve të përcaktuara nga Ligji mbi hidrokarburet për operatorët ekonomikë të naftës dhe të gazit. Në mënyrë që të arrihet një efikasë më e mirë në kërkim dhe prodhim, ligji i lejon Albpetrolit t'i transferoi të drejtat në kërkimi dhe prodhimi, duke nën-liçensuar shoqëritë të naftës dhe gazit, pas miratimit nga Ministria e Energjisë dhe Industrisë.

¹ Përmbledhje e kontekstit ligjor shqiptar mbi kërkimin dhe prodhimin e hidrokarbureve – www.akbn.gov.al.

Qeverisja e Albpetrol

Asambleja e Përgjithshme ("Asambleja") është organi më i lartë qeverisës i Albpetrol. Asambleja emëron anëtarët e Këshillit Mbikqyrës ("Këshilli") i cili mbikqyr aktivitetet operative dhe financiare si dhe kontrollet e brendshme të Shoqërisë. Asambleja emëron administratorin e Shoqërisë me një mandate tre-vjeçar, bazuar në kriteret e përcaktuara nga Këshilli Mikqyrës. Në përputhje me statutin e Albpetrol, administrimi dhe mbikqyrja e Shoqërisë janë dy funksione të veçanta, ku administrator raporton tek Këshilli Mikqyrës dhe nuk mund të jetë pjesë e tij. Përveç të tjerash, Këshilli mikqyrës përcakton kompensimin e administratorit.

Këshilli mikqyrës përbehet nga anëtarë me profesione të ndryshme që përfaqësojnë Qeverinë. Aktualisht, Këshilli Mikqyrës drejtohet nga **Z. Koli Bele**, Sekretar i Përgjithshëm i Ministrisë së Energjisë dhe Industrisë dhe përfshin nga anëtarët e mëposhtëm:

- **Z. Dritan Spahiu**, Anëtar dhe Drejtor i Drejtorisë së Politikave dhe Zhvillimit të Hidrokarbureve pranë Ministrisë së Energjisë dhe Industrisë;
- **Z. Artur Metani**, Anëtar dhe Drejtor i Byrosë Kombëtare të Investigimit dhe më herët këshilltar juridik i Presidentit të Republikës së Shqipërisë;
- **Z. Ardit Çollaku**, Anëtar dhe Këshilltar i Ministrisë të Zhvillimit Ekonomik, Tregtisë dhe Sipërmarrjes;
- **Zj. Etleva Kondi**, Anëtar dhe Drejtor e Konçensioneve, Prokurimeve dhe Privatizimit pranë Ministrisë së Energjisë dhe Industrisë; dhe
- **Z. Andius Oildashi**, Anëtar dhe Drejtues i Partisë Socialiste në Fier.

Përcaktimi i çmimit të naftës

Në pasqyrat vjetore të Albpetrol për vitin 2012 paraqitet se shitja e naftës së Albpetrol për vitin 2012 është rregulluar nga urdhëri numër 83 datë 10 shkurt 2012 "Për rregullat dhe procedurat e shitjes së produkteve hidrokarbure" i Ministrisë të Zhvillimit Ekonomik, Tregtisë dhe Sipërmarrjes, ndryshuar me urdhërin numër 635 datë 13 shtator 2012. Sipas këtij urdhëri, administratori i Shoqërisë propozon kriteret për përcaktimin e çmimit të naftës të cilat miratohen nga komiteti i ekspertëve dhe Ministrisë të Zhvillimit Ekonomik, Tregtisë dhe Sipërmarrjes. Pas miratimit të kriteve Shoqëria nis procedurat për ankandet.

Megithatë, këto pasqyra financiare nuk paraqesin të dhëna për çmimet e përcaktuara dhe për kontraktorët e kontratat e shitjes së naftës në fuqi gjatë vitit 2012.

2.1.3 Marrëveshjet hidrokarbure

Të gjitha marrëveshjet hidrokarbure janë hartuar si Marrëveshje me Ndarje të Prodhimit ("MNP" ose "PSA"), të nënshkruara nga Agjensia Kombëtare e Burimeve Natyrore (AKBN) si përfaqësuese e Qeverisë Shqipëtare. **Albpetrol, është palë në këto marrëveshje kur ato i referohen të drejtave dhe zonave për kërkim-prodhim nën administrimin e tij.** PSA-të për fushat naftë-mbjtëse të zbuluara, janë dhënë për një periudhë fillestare prodhimi jo më shumë se 25 vjet, afat që mund të zgjatet në përputhje me ligjin për hidrokarburet.

Ligji për hidrokarburet përkufizon PSA-të si marrëveshje ku:

- Shoqëria e licënsuar mund të mbulojë kostot e Kontratës nga hidrokarburet e prodhuara në Zonën e përcaktuar në Kontratë ose në një pjesë proporcionale të saj; dhe
- Sasia e hidrokarbureve gjëndje pas mbulimit të kostove të Kontratës ndahet ndërmjet Shtetit dhe Kontraktorit, në përputhje me një formulë të përcaktuar në Marrëveshjen e Hidrokarbureve².

Kushtet e hollësishme të Marrëveshjeve Hidrokarbure konsiderohen sekret tregtare dhe aktualisht nuk janë të publikuara për të gjithë.

² Ligji nr. 7746 "Për hidrokarburet (Kërkim dhe Prodhim), Neni 2

Kushtet dhe termat kryesore e marrëveshjeve të naftës³ janë të paraqitur si më poshtë:

1. Kohëzgjatja e Periudhës së Kërkimit

Kohëzgjatja e periudhës së kërkimit është 5 vjet dhe mund të zgjatet deri në 7 vjet në përputhje me Ligjin për hidrokarburet. Periudha e kërkimit është ndarë në tri faza, ku secila ka detyrimet për punime dhe angazhime financiare më vete. Kontraktori nuk mund të kalojë në një fazë të mëtejshme, pa plotësuar detyrimet për punime dhe angazhimet financiare të fazes së mëparshme. Kohëzgjatja e çdo faze të periudhës kërkimit është subjekt negocimi.

2. Kohëzgjatja e periudhës së zhvillimit dhe prodhimit

Në rast zbulimi, periudha për zhvillim dhe prodhim në zonën e përcaktuar do të jetë njëzet e pesë vjet dhe mund të zgjatet më tej siç parashikohet në Ligjin për hidrokarburet.

3. Detyrimet e minimale të punës dhe angazhimet financiare

Këto detyrime propozohen nga Kontraktori në aplikimin drejtuar AKBN-së. Ato mund të negocjohen para se të përfshihen në marrëveshje.

4. Fondi i administrimit dhe trajnimit

Shuma do të specifikohet nga Kontraktori në aplikimin e tij dhe do të jetë subjekt i negociatave.

5. Rekuperimi i kostove dhe ndarja e prodhimit

Kushtet për rikuperimin e kostove dhe ndarjen e prodhimit të naftës do të përcaktohen nga kontraktori në aplikimin e tij dhe do të jenë subjekt negocimi para se të përfshihen në marrëveshje.

Kontraktori do të ketë të drejtë të mbledhë dhe të mbajë jashtë shtetit të ardhurat nga shitjet në eksport në masën që ata nuk janë të nevojshme për të përmbushur në mënyrë të vazhdueshme kostot lokale të monedhën vendase.

6. Bonusi

Bonusi është i pagueshme në faza të ndryshme të marrëveshjes PSA, përfshirë edhe bonusin e nënshkrimit. Bonus i prodhimit dhe bonus nënshkrimi përlllogariten në varësi të sipërfaqes dhe janë subjekt negocimi.

³ Mundësitë e kërkimit dhe prodhimit të naftës në Shqipëri”, publikuar nga AKBN– www.akbn.gov.al

2.1.4 Kërkimi, zhvillimi dhe prodhimi në sektorin minerar

Sektori minerar në Shqipëri rregullohet nga Ligji nr. 10304 "Për sektorin e Minerar në Republikën e Shqipërisë", datë 15 korrik 2010 ("Ligji Minerar"), i cili hyri në fuqi në gusht të vitit 2010 dhe shfuqizoi Ligjin Minerar të mëparshëm nr. 7796, datë 17 shkurt 1994. Pavarësisht se ligji hyri në fuqi në vitin 2010, zbatimi i plote i tij filloi në mesin e vitit 2011, pas miratimit dhe publikimit të udhëzimit shoqëruese.

Afati fillestar për liçensën e shfrytëzimit për prodhim është 25 vjet, subjekt i rinovimit deri në 10 vite shtesë. Liçensat e kërkimit jepen fillimisht për 3 vjet, subjekt i shtyrjes së mëtejshme në afat. AKBN dhe Shërbimi Gjeologjik Shqiptar ("SHGJSH") mbështesin MEI-n në procedurat para dhe pas liçensimit, përkatësisht AKBN për liçensat e prodhimit dhe SHGJSH për liçensat e kërkimit.

Sipas Ligjit të ri Minerar, të liçensuarit në këtë sektor nuk janë të detyruar të paguajnë më taksën mbi sipërfaqen. Në vend të saj, ligji i ri paraqet konceptin e përfshirjes së planit të rehabilitimit mjedisor dhe të planit vjetor të punës dhe investimeve. Plani vjetor miratohet nga AKBN për liçensat e prodhimit dhe nga SHGJSH për lejet e kërkimit sipas kushteve të çdo liçense. Në vijim, të liçensuarit depozitojnë çdo vit garanci financiare, në përputhje me planet vjetore të miratuara.

Kushtet e detajuara të kontratave të konçensionit minerar konsiderohen sekret tregtare dhe aktualisht nuk janë aksesueshme për publikun.

2.1.5 Rregullimi i raportimit EITI

Neni 36 i Ligjit Minerar shprehimisht detyron shoqëritë e liçensuara në këtë sektor të raportojnë pagesat e tyre tatimore në përputhje me Nismën për Transparencë në Industrinë Nxjerrëse. Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 233, datë 23 mars 2011 paraqet udhëzimet kryesore për raportimin EITI.

Përmbledhja e ligjeve dhe rregulloreve në fuqi për sektorin e minerar është dhënë nga AKBN dhe MEI në faqet e tyre të internetit përkatësisht: www.akbn.gov.al dhe www.energjia.gov.al.

2.1.6 Ndryshimet në kuadrin ligjor

Në tetor 2014, Parlamenti Shqiptar miratoi disa ndryshime të Ligjit Minerar. Ndryshimet në ligj i japin AlbEITI-t të drejtë të kërkojë dhe të mbledh informacion për pagesat tatimore nga të liçensuarit në këtë sektor, autoritetet tatimore e doganore dhe njësitë e qeverisjes vendore, si dhe ta publikojë këtë informacion në raportin EITI.

Më tutje, ndryshimet në ligj përcaktojnë kriteret për nën-kontraktimin, i cili është një fenomen mjaft i përhapur në aktivitetin minerar. Këto ndryshime kërkojnë shprehimisht që nënkontraktori për operacionet e kërkimit dhe / apo prodhimit të miratohet nga Ministri i Energjisë dhe Industrisë pas përmbushjes së kushteve teknike dhe financiare.

Gjithashtu, ndryshimet në ligj parashikojnë punësimin e stafit teknik përgjatë gjithë të periudhës së liçensës së kërkimit dhe / apo prodhimit

Parlamenti Shqiptar publikon rregullisht në faqen e tij zyrtare të internetit www.parlament.al, të gjitha amendimet dhe ndryshimet e ligjeve në pritje për miratim.

2.2 Pamje e përgjithshme e sektorit të naftës dhe gazit

2.2.1 Aktiviteti i kërkimit dhe rezervat a naftës dhe gazit ⁴

Studimet gjeologjike në Shqipëri tregojnë për mundësi kërkimi dhe prodhimi të naftës në tokë dhe në det. Kërkimi i naftës në Shqipëri filloi në vitin 1918 . Që nga ajo kohë, u zbluluan fusha naftë-mbajtëse në 11 zona tokësore duke përfshirë: Drashovicën (1918), Patosin (1927), Kuçovën (1928), Marinzën (1957), Visokën (1963), Gorisht-Koçul (1965), Ballsh-Hekal (1966), Finiq-Krane (1973), Çakran-Mollaj (1977), Delvinën (1989) and Sqepurin (2001). Kërkimi i gazit në Shqipëri filloi në vitin 1955. Fusha e parë gaz-mbajtëse u zbulua në Divjakë (1963), e ndjekur nga Frakulla (1965), Ballaj-Kryevidhi (1983), Povelça (1987), Panaja (1988). Në vitin 1994, shoqëria italiane Agip zbuloi bllokun e parë të gazit në det, Adriatik-4.

Nafta ishte industria e parë që tërhoqi investime të huaja direkte, pas rënies së sistemit ekonomik komunist. Nga viti 1991 deri më sot, janë nënshkruar disa kontrata me shoqëri të huaja që janë përfshirë në kërkimin e naftës dhe të gazit në vend, si më poshtë:

Kërkimi në det: Deminex, OMV, Agip, Hamilton Oil, Edison Gas, Occidental Petroleum, Chevron, BHP Petroleum, Svenska Petroleum Exploration, Premier Consolidated Oilfields, Lundin Petroleum, Capricorn Albania, San Leon Energy, Beach Petroleum and Emanuelle Adriatic Energy

Kërkimi në tokë: Shell, Occidental Petroleum, OMV, Ina Naftaplin, Coparex, Lundin Petroleum, Premier Consolidated Oilfields, Enterprise, Clyde Expro PLC, MOL, Hellenic Petroleum, Anschutz, IPC, Bankers Petroleum, Petromanas Albania GmbH and Albanides Energy.

Zbulimi i parë i naftës në tokë në Shqipëri pas vitit 1990 u bë nga Occidental Petroleum në vitin 2001, pas shpimit të të pusit të parë në zonën Shpiragu-1, në Bllokun 2 (quajtur ndryshe fusha naftë-mbajtëse e Sqepurit, shih tabelën 5).

Në tabelën 5, më poshtë paraqitet një përmbledhje e historisë së kërkimit në Shqipëri, ndërsa v vendndodhja e fushave të naftës dhe gazit paraqitet në figurën 2.

Tabela 5 – Përmbledhje e aktivitetit të kërkimit në Shqipëri

Fusha	Viti i zbulimit	Lloji i rezervuarit	Thellësia e rezervuarit (m)	Dendësia e naftës dhe gazit (api)	Përmbajtja e sqfurit (%)
Drashovica	1918	Oligoc-flysch	100-200	Naftë < 10 °	n/i
Patos	1927	Mess-clastics	Surf. To 1200	Naftë (12-24° API)	2.5-6
Kuçova	1928	Mess-clastics	Surf. To 1500	Naftë (13-16° API)	4
Marinëza	1957	Mess-clastics	1200-1800	Naftë (12-35° API)	4-6
Visoka	1963	Cret/Eoc.Carb	800-1000	Naftë (5-16° API)	5-6
Gorisht- Koçul	1965	Cret/Eoc.Carb	1000-2500	Naftë (17° API)	6
Ballsh-Hekal	1966	Cret/Eoc.Carb	1000-3000	Naftë (12-24° API)	5.7-8.4
Çakran-Mollaj	1977	Cret/Eoc.Carb	3000-4500	Naftë 14-37 ° API	0.9
Finiq- Krane	1973	Cret/Eoc.Carb	800-2000	Kond, 52 ° API	3.7-4.3
Delvina	1989	Cret/Eoc.Carb	2800-3400	Naftë (<10° API)	0.7
Divjaka	1963	Tort/clastics	2400-3000	Kond. 53 ° API	n/i
Ballaj-Kryevidh	1983	Piloc/clastics	300-1700	Gaz & Kondens	n/i
Frakull	1965	Mess-clastics	300-2500	Gaz	n/i
Povelça	1987	Mess-clastics	1800-3500	Gaz	n/i
Povelça	1987	Mess-clastics	1800-3500	Gaz & Kondens	n/i
Panaja	1988	Mess-clastics	2500	Gaz	n/i
Adriatik-4 (në det)	1994	Mess-clastics	2500-3100	Biogjenik Gaz & Kond. 54.3° API	n/i
Sqepuri	2001	Cret/Eoc.Carb	4950	Naftë (37° API)	2.3

n/i – nuk ka informacion

Informacione të detajuara mbi formacionin gjeologjik të territorit të Shqipërisë, duke përfshirë mundësitë në zonat tokësore dhe detare janë paraqitur në broshurën “Mundësitë e kërkimit dhe prodhimit të naftës në Shqipëri”, publikuar nga AKBN në: www.akbn.gov.al.

⁴ “Mundësitë e kërkimit dhe prodhimit të naftës në Shqipëri” dhe “Investoni në Burimet Natyrore të Shqipërisë – Burimet Minerare”, publikuar nga AKBN– www.akbn.gov.al

2.2 Licensing situation in 2012⁵
Rezervat e naftës dhe gazit

Bazuar në studimet e kryera nga shoqëritë e huaja dhe Albpetrol në vitet 1985-1990, rezervat e naftës në vendburimet e zbuluara në Shqipëri arrinin në rreth 437.6 milion ton⁵, megjithatë rezervat e rekuverueshme sipas vlerësimeve të atëherëshme nuk i kalonin 81 milion ton⁵. Rezervat e naftës në Shqipëri përgjithësisht ndodhen në shtresat terciare në jug-perendim të Shqipërisë, kryesisht në trekëndëshin e kufizuar nga Vlora, Berati dhe Durrësi.

Rezervat në vendburimet e zbuluara të gazit natyror në Shqipëri përllogariten në 18,164 milion Nm³ dhe shtrihen kryesisht në zonën e Kuçovës dhe Patosit. Sasia kumulative e gazit të prodhuar deri në fund të vitit 2012 ishte 12,504 milion Nm³. Tabela më poshtë paraqet vlerësimet e rezervave gjeologjike dhe të rekuverueshme në fushat ekzistuese të naftës në milion ton:


Tabela 6 - Rezervat gjeologjike dhe të rekuverueshme të naftës në milion ton

Fushat naftëmbajtëse	Rezervat në milion ton		Prodhimi kumulativ deri në 2012
	Gjeologjike	Rekuveruar	
Cakran –Mollaj	16.1	8.1	4.2
Ballsh-Hekal	19.7	6.5	5.1
Gorisht –Kocul	30.5	14.7	11.9
Amonice	2.8	1.5	0.7
Visokë	28.4	6.8	6.2
Delvine	0.3	0.1	-
Finiq –Krane	1	0.2	-
Drashovica	0.1	-	-
Total shkëmbinj gëlqeror	98.9	37.9	28.1
Marinëza	258.4	31.2	23.1
Kuçova	80.3	12	4.2
Total shkëmbinj ranor	338.7	43.2	27.3
Totali	437.6	81.1	55.4

Siç paraqitet më sipër, rezervat kryesore të naftës (**99% e rezervave gjeologjike**) ndodhen në:

- **2 zona ranore:** Kuçova dhe Marinëza, të cilat së bashku përbëjnë 77% të rezervave gjeologjike dhe 53% te rezervave të rekuverueshme; dhe
- **4 zona gëlqerore:** Cakran –Mollaj, Ballsh-Hekal, Gorisht –Kocul dhe Visoka, të cilat së bashku përbëjnë 22% të rezervave gjeologjike dhe 45% te rezervave të rekuverueshme.

Figura 2 – Fushat e naftës dhe gazit në Shqipëri



⁵ Adresa: <http://www.albpetrol.al/rezervat-gjeologjike/>

2.2.2 Situata e liçensimit në vitin 2012

Marrëveshjet e hidrokarbureve, si më poshtë, ishin në fazën e prodhimit gjatë vitit 2012:

Grupi	Shoqëria e liçensuar	Data e marrëveshjes hidrokarbure	Zona e operimit (tokësore)	Faqja e internetit
Bankers Petroleum Ltd.	Bankers Petroleum Albania Ltd	Korrik 2004	▪ Patos-Marinëz,	www.bankerspetroleum.com
	Sherwood International Petroleum Ltd	Shtator 2007	▪ Kuçovë	www.bankerspetroleum.com
Stream Oil & Gas Ltd.	Dega ne Shqiperi e Stream Oil & Gas Ltd (<i>tashmë Transatlantic Petroleum Ltd</i>)	Gusht 2007	▪ Gorisht-Kocul, ▪ Cakran-Mollaj, ▪ Ballsh-Hekalit ▪ Delvinë	www.streamoilandgas.com
Transoilgroup AG	Transoil Group -Dega ne Shqiperi	Shkurt 2012	▪ Visokë	www.transoilgroup.com

Të gjitha Marrëveshjet Hidrokarbure për zhvillimin dhe prodhimin e naftës dhe gazit e paraqitura më sipër, ishin nënshkruar nga Albpetrol, në cilësinë e tij si i liçensuar primar. Rrjedhimisht, Albpetrol mbajti pjesë nga prodhimi i gjeneruar nga këto marrëveshje. Gjithashtu, Albpetrol operoi ekskluzivisht në:

- fushat e naftës dhe gazit në 2012: Pekish-Murriz, Frakull, Panaja, Povelçe, Divjakë, Ballaj-Kryevdh, Finiq-Karne, Amonicë and Drashovicë (referojuni **Figurës 1**);
- blloqet tokësore të kërkimit: 1, 4-8, C, Dumre, Panaja, Povelçe (referojuni **Figurës 2**); dhe
- blloku detar i Rodonit verior (referojuni **Figurës 2**).

Në vitin 2013 Albpetrol kaloji shoqërisë Phoenix Petroleum Sh.a. të drejtat e shfrytëzimit dhe prodhimit në Pekish-Murriz, Frakullë, Panaja, Povelçe, Divjakë, Ballaj-Kryevdh, Finiq-Karne, Amonicë dhe Drashovicë⁶.

Në shtator 2014 Transatlantic Petroleum Ltd arriti në një marrëveshje për blerjen e operacioneve të Stream Oil & Gas në Shqipëri, për një shumë prej 41 milionë dollarësh.


Marrëveshjet e hidrokarbureve, si më poshtë, ishin në fazën e kërkimit gjatë vitit 2012:

Grupi	Shoqëria e liçensuar	Data e marrëveshjes hidrokarbure	Zona e operimit	Faqja e internetit
Bankers Petroleum Ltd.	Bankers Petroleum Albania Ltd	Nëntor 2010	▪ Blloku F në tokë	www.bankerspetroleum.com
Petromanas Energy Inc.	Petromanas Albania GmbH.	Dhjetor 2007	▪ Blloqet A, B, D, E në tokë;	www.petromanas.com
Royal Dutch Shell plc & Petromanas Energy Inc.	Royal Dutch Shell plc & Petromanas Albania GmbH.	Korrik 2009	▪ Blloqet, 2, 3, në tokë	www.royaldutchshellplc.com www.petromanas.com
San Leon Energy plc	San Leon Durrësi B.V.	Gusht 2007	▪ Blloku Durrës, në det,	www.sanleonenergy.com
Cairn Energy PLC	Capricorn Albania Limited and Dyas Albania (<i>më parë Orion Albania Limited</i>)	Shtator 2007	▪ Blloku Joni 5 në det	www.cairnenergy.com
Sky Petroleum, Inc.	Sky Petroleum - Albanian Branch, (<i>pezulloi aktivitetin në vitin 2012</i>)	June 2010	▪ Blloqet 4, 5 dhe Dumre, në tokë	www.skypetroleum.com
The Israel Land Development Shoqëria Ltd (ILD).	Emanuelle Adriatic Energy Ltd	Gusht 2004	▪ Blloqet Adriatiku 2 – 3 – 4, në det	http://en.ildc.co.il/

⁶Marrë nga faqja e internetit të Shoqërisë: <http://imc.al/p-oil-gas.html>

2.2.3 Prodhimi i naftës dhe gazit

Grafiku 1 – Prodhimi i naftës nga Albpetrol dhe sektori privat në vitet 1992-2013




Prodhimi i naftës në Shqipëri filloi në vitin 1929, me 750 ton naftë bruto në vit. Pas Luftës së Dytë Botërore prodhimin u rrit në mënyrë të qëndrueshme dhe arriti pikun në vitin 1974 me një prodhim prej 2.25 milion ton në vit. Në vitet '80 prodhimi i naftës ra nën 1 milion ton në vit dhe arriti përsëri në mbi 1 milion ton në vitin 2012.

Grafiku në të majtë paraqet trendin e prodhimit të naftës nga viti 1992 deri në 2013.

Prodhimi i naftës nga marrëveshjet hidrokarbure u trefishura në pesë vitet e fundit.

Grafiku 2- Nafta e prodhuar në vitin 2012 nga të licënsuarit



Në 2012, AKBN raportoi se prodhimin e naftës bruto në 1,029,300 ton⁷ (2011: 894,500 ton) me një vlerë prej 484 milion USD (2011: 456.5 milion USD).

Në vitin 2012, 96% e naftës bruto u prodhuan nga sektori privat (2011: 93% e naftës bruto)

Ky prodhim është nxjerrë kryesisht nga fusha e Patos-Marinzës nga Bankers Petroleum, përkatësisht 86% e prodhimit total të naftës bruto.

Në 2012, Albpetrol raportoi se prodhimin e gazit ishte 13.1 milion Nm^{3,8}, nga i cili 12.5 milion Nm³ gaz ishte gaz shoqërues i naftës (2011: prodhim total 13.7 milion Nm³, ku 12.4 milion Nm³ ishte gaz shoqërues i naftës).

⁷ Ky informacion është dërguar zyrtarisht nga AKBN tek Sekretariati ALBEITI dhe ky i fundit e prezantoi në këtë raport.

⁸ Ky informacion është dërguar zyrtarisht tek Albpetrol to ALBEITI dhe ky i fundit e prezantoi në këtë raport.

2.2.4 Situata e liçensimit dhe blloqet e lira të kërkimit në Tetor 2014


Tabela 7 më poshtë liston të gjitha blloqet e kërkimit të naftës dhe gazit në tokë dhe në det në territorin e Shqipërisë në tetor 2014, duke specifikuar situatën aktuale të liçensimit dhe blloqet e lira.

Tabela 7 – Lista e blloqet e kërkimit

Nr.	Vendodhja	Blloqet	Operuar nga / I Lirë	Liçensa e administruar nga
1	Në det	Bloku Rodoni Veri	I lirë	Albpetrol
2	Në det	Bloku Adriatiku 2	Emanuelle Energy	AKBN
3	Në det	Bloku Adriatiku 3	Emanuelle Energy	AKBN
4	Në det	Bloku Adriatiku 4	Emanuelle Energy	AKBN
5	Në det	Bloku Joni 5	Capricorn Albania & Dyas Albania	AKBN
6	Në tokë	Bloku 1	I lirë	Albpetrol
7	Në tokë	Bloku 2	Petromanas & Shell	AKBN
8	Në tokë	Bloku 3	Petromanas & Shell	AKBN
9	Në tokë	Bloku 4	I lirë	Albpetrol
10	Në tokë	Bloku 5	I lirë	Albpetrol
11	Në tokë	Bloku 6	I lirë	Albpetrol
12	Në tokë	Bloku 7	I lirë	Albpetrol
13	Në tokë	Bloku 8	Albanides Energy	AKBN
14	Në tokë	Bloku A	I lirë	Albpetrol
15	Në tokë	Bloku B	I lirë	Albpetrol
16	Në tokë	Bloku C	I lirë	Albpetrol
17	Në tokë	Bloku D	Petromanas	AKBN
18	Në tokë	Bloku E	Petromanas	AKBN
19	Në tokë	Bloku F	Bankers Petroleum	AKBN
20	Në tokë	Bloku Dumre	I lire	Albpetrol
21	Në tokë	Bloku Panaja	I lire	Albpetrol
22	Në tokë	Bloku Velca	I lire	Albpetrol
23	Në tokë	Bloku Delvina	Stream oil and gas	AKBN

Ministria e Energjisë dhe Industrisë nëpërmjet AKBN-së promovon vashdimisht blloqet e lira në tokë dhe në det dhe fton investitorët të aplikojnë për të lidhur Marrëveshje Hidrokarbure.

Figura 3 – Situata blloqeve të kërkimit në Tetor 2014



2.2.5 Rafinimi dhe transporti i naftës

ARMO Sh.a. ("ARMO") është Shoqëria e vetme e rafinimit të naftës që operon në Shqipëri. Ajo u themelua si rrjedhojë e ndarjes së Shoqërisë së naftës së zotëruar nga shteti Albpetrol Sh.a. në prill 1999. Në gusht 2008, Shteti Shqiptar privatizoi 85% të aksioneve të ARMO-s tek Anika Mercuria Refinery Associated Oil ("AMRA Oil"). Në gusht 2013, Heaney Asset Corporation bleu 80% të aksioneve të AMRA Oil, duke kontrolluar kështu 68% të interesave tek ARMO.

ARMO operon dy rafineri naftë përkatësisht në Ballsh dhe Fier, që punojnë konsiderueshëm nën kapacitetet për shkak të vjetërimit teknologjik. Misioni i ARMO-s është përmirësimi i teknologjisë së rafinimit dhe i pozicionit të tij në tregun rajonal të naftës.

Nafta bruto transportohet me çisterna nga fushat e naftës në portin e Vlorës, nga ku eksportohet për në Itali, Spanjë, Maltë etj.

Dy tubacione për transportin e naftës bruto lidhin terminalin e naftës së ARMOs në Vlorë me rafineritë e Fierit dhe Ballshit si dhe dy rafineritë mes tyre. Të dy tubacionet janë jashtë funksionit për shkak të vjetërimit. Në total, rrjeti i tubacioneve të naftës ka një gjatësi prej 188 km dhe kapacitet prej 2.5 milion ton në vit⁹.

Shoqëria La Petrolifera Italo-Albanese Sh.a. operon terminalin bregdetar për naftën, gazin e lëngshëm të naftës dhe derivatet e tjera në portin e Vlorës, si dhe mundëson magazinim e naftës bruto që do të eksportohet në depozitat e saj në port. Shoqëria ofron një infrastrukturë që mund të mbajë më shumë se dy anije njëkohësisht. Asnjë shoqëri shtetërore nuk operon në këtë sektor.

2.2.6 Depozitimi i naftës dhe gazit

Fushat e naftës dhe gazit nga ku janë nxjerrë të gjitha ose një pjesë e rezervave, mund të përdoren si vende depozitimi për gazin natyror për shkak të kushteve të përshtatshme gjeologjike. Kriporet në Dumre janë gjithashtu shumë të përshtatshme për ruajtjen e gazit natyror gjatë verës. Këto avantazhe gjeologjike të kombinuara me pozicionin gjeopolitik, e bëjnë Shqipërinë një vend tërheqës për projektin e gazsjellësit.

2.2.7 Gazsjellësi Trans Adriatik (projekti TAP)

Gazsjellësi Trans Adriatik (TAP) AG është një Shoqëri me sipërmarrje të përbashkët e themeluar me qëllimin e planifikimit, zhvillimit dhe ndërtimit të gazsjellësit natyror TAP. Aksionarët e TAP janë: BP (20%), SOCAR (20%), Statoil (20%), Fluxys (19%), Enagás (16%) dhe Axpo (5%).

TAP do të transportojë gaz natyror nga fusha Shah Deniz II në Azerbajxhan për në Evropë. Afërsisht 870 km tubacion do të lidhet me Gazsjellësin Trans Anatolian (TANAP) pranë kufirit turko-grek në Kipoi, do kalojë Greqi, Shqipëri dhe detin Adriatik, e më pas do të lidhet me bregdetin e Italisë Jugore. Kështu, Shqipëria do të bëhet një vend tranzit qendror energjinë në Bashkimin Evropian, por edhe për diversifikimin e burimeve të furnizimit me gaz, duke shënuar kështu hapjen e Korridorit Jugor të Gazit për Europën. TAP pritet të nxisë zhvillimin ekonomik dhe krijimin e vendeve të punës përgjatë rrugës së gazsjellësit, duke përfshirë Shqipërinë. Ky do të jetë një burim i madh i investimeve të huaja direkte që nuk varet nga grantet ose subvencionet. Shitjet e para të planifikuara të gazit kanë objektiv Gjeorgjinë dhe Turqinë në fundin e vitit 2018, dërgesat e para në Evropë do të pasojnë afërsisht një vit më vonë.

Informacione të mëtejshme mbi projektin e TAP mund t'i gjeni në: <http://www.tap-ag.al/> dhe www.energija.gov.al.

Qeveria shqiptare është angazhuar plotësisht për të mbështur projektin TAP në të gjitha hapat e autorizimeve dhe lejeve shtetërore. Me qëllim lehtësimin e procesit, Qeveria themeloi "Komisionin për Ndihmë Shtetërore" drejtuar nga Ministri i Zhvillimit Ekonomik, Tregtisë dhe Sipërmarrjes sipas ligjit nr. 9374, datë 21 prill 2005 "Mbi ndihmat shtetërore", i ndryshuar. Ndërtimi i TAP-it në Shqipëri është parashikuar të fillojë në 2015.

Marrëveshja TAP dhe të ardhurat që pritet të marrë Shteti nga ky projekt nuk janë të publikuara. Sipas MEI-t, në përputhje me rregullat e Bashkimit Evropian për tranzitin e lirë të gazit, marrëveshja nuk parashikon ndonjë tarifë për tranzitin e gazit. Megjithatë, përveç përfitimeve ekonomike që priten nga ky projekt, Shqipëria do të përfitojë gjithashtu 7 milion EUR për forcimin e kapaciteteve dhe kompensim për komunitetin përreth rrugëtimit të TAP në Shqipëri.

⁹ Burimi: Emergency Oil Stocks in the Energy Community Level, Petroleum Development Consultant Limited, Energetski Institut Hrvoje Požar, Prill 2011

2.3 Pamje e përgjithshme e sektorit mineralar

Shqipëria ka një histori të gjatë në sektorin mineralar me depozita të mëdha të mineraleve të kromit, nikelit, bakrit dhe gurit gëlqeror. Studimet gjeologjike të kryera në vitet 1945-1995, kanë zbuluar depozita të konsiderueshme të mineralit të kromit, ferronikelit, bakrit, bitumit, dhe minerale jo-metallore si gur gëlqeror dhe gurë dekorativë etj

Zhvillimi i industrisë minerare në Shqipëri ka kaluar nëpër tri faza kryesore. *Faza e parë përfshin* periudhën deri në fund të Luftës së Dytë Botërore, i cila shënoi nga dy ngjarje të rëndësishme: përpilimin për herë të parë të Hartës Gjeologjike të Shqipërisë në 1922, dhe miratimit të Ligjit Mineralar në vitin 1929. *Në fazën e dytë (1944-1994)*, aktiviteti i minierave u organizua në ndërmarrje shtetërore. *Faza e tretë përfshin periudhën nga viti 1994 deri më sot*, kur sektori mineralar u hap për privatizimin e operacioneve minerare, pas miratimit të Ligjit Mineralar Shqiptar.

Si një vend tradicional mineralar, Shqipëria ka një numër në rritje të shoqërive të vogla dhe të mesme në sektorin mineralar dhe të karrierës, si dhe numëron vetëm disa shoqëri të mëdha industriale. Në Nentor 2011, AKBN raportoi 752 licenca minerare, nga të cilat 673 licenca në prodhimi, që vepronin kryesisht në rrethin e Bulqizës (136), Krujës (65), Beratit (45), Tiranës (48) dhe Librazhdit (40).

Minerali i kromit

Studimet gjeologjike tregojnë se Shqipëria ka më shumë se 36.9 milion ton¹⁰ rezerva kromi, të depozituara kryesisht në afërsi të Bulqizës, Kukësit, Hasit, Matit, dhe Pogradecit.

Shqipëria njihet për potencialin e lartë të depozitave të kromit krahasuar me vendet e tjera të Mesdheut dhe Ballkanit.

Nga gjithë rezervat e zbuluara të kromit, përlllogaritet që 7 milion ton krom kanë cilësi të lartë 42-46% Cr₂O₃.


Para viteve 90, prodhimi vlerësohej të ishte deri në 1.3 milion ton krom në vit. Nga ky prodhim 250,000 ton ishin krom me cilësi të lartë 42-46% Cr₂O₃.

Eksporti i kromit dhe i produkteve të tij i ka qënë një nga burimet kryesore të të ardhurave për vendin tonë.

Në fund të viteve 1980, Shqipëria ia eksportonte produktet e saj kryesisht Suedisë, Republikës Federale të Gjermanisë (Gjermania Perëndimore), Jugosllavisë dhe vendeve të Evropës Lindore.

Tashmë, kromi kryesisht eksportohet drejt Kinës.

Figura 4 - Harta e depozitave të kromit



¹⁰Investoni në Burimet Natyrore të Shqipërisë – Burimet Minerare, publikuar më 10 gusht 2010 nga Agjensia Kombëtare e Burimeve Natyrore (AKBN) – www.akbn.gov.al

Minerali i bakrit

Depozitat kryesore të bakrit, të vlerësuara rreth 27 milion ton¹¹, ndodhen në qytetet veriore të Pukës, Mirditës, Kukësit, Hasit dhe Shkodrës. Gjatë viteve 1980, industria e bakrit ishte më e suksesshme në sektorin e nxjerrjes së mineraleve. Prodhimi i bakrit u rrit ndjeshëm nga rreth 140 mijë ton në vitin 2010 në 480 mijë ton metrikë në vitin 2012 (shih tabelën 8).

Figura 5 - Harta e depozitave të bakrit




Minerali i hekur-nikelit dhe nickel-silikate

Depozitat e hekur-nikelit dhe nikel-silikatit në Shqipëri vlerësohen rreth 311¹¹ milion ton dhe ndodhen pranë Pogradecit, Librazhdit, Bilishtit, Kukësit dhe Peshkopisë. Kombinati Metalurgjik i Elbasanit ishte kompleksi më i madh industrial në Shqipëri.

Prodhimi mesatar vjetor i hekur-nikelit dhe nikel-silikate varioje nga 215 mijë ton në 370 mijë ton. Në 2009 dhe 2012, prodhimi ra në nivelin 69 mijë ton dhe 75 mijë ton si rrjedhojë e rënies së kërkesës në treg (shih tabelën 8).

Figura 6 – Harta e depozitave të nikelit



Depozitat e bitumit dhe asfaltit ndodhen në afërsi të Selenicës në luginës së lumit Vjosë. Shqipëria gjithashtu zotëron depozita të mëdha të kripës, në afërsi të Kavajës dhe Vlorës.

Guri gelqeror dhe minerale të tjera

Studimet gjeologjike në Shqipëri deri në 1995 tregojnë për 32 lloje të ndryshme të shkëmbinjve dhe mineraleve jometalorë industrialë, përgjatë gjithë vendin, duke përfshirë: shkëmbijtë gelqeror, shkëmbijtë ranor, dolomitët, gurë dekorative karbonatikë, argjilë, granitit, gips etj

Këto minerale mund të nxirren përgjatë gjithë vendit tonë. Ato përbëjnë lëndën e parë kryesore për industrinë e ndërtimit në Shqipëri.

Një pamje e përgjithshme e potencialit mineral jepet nga Agjensia Kombëtare e Burimeve Natyrore në faqjen e saj të internetit: www.akbn.gov.al.

Përpunimi i mineraleve

Sektori mineral, i dominuar më parë nga ndërmarrjet shtetërore, u hap ndaj investimeve të huaja private në vitin 1994. Objektet minerare të dhëna me konçesion deri më tani janë si më poshtë:

- Miniera e kromit në Bulqizë, Minerat Pojske dhe Katjel, fabrika e pasurimit në Bulqizë, Impjanti i seleksionimit në Klos, Uzina e ferrokromit në Elbasan dhe Burrel;
- Minierat e kromit në Kalimash, rrethin e Kukësit, Vlahnë, rrethin e Hasit dhe fabrika e pasurimit në Kalimash;
- Minierat e bakrit në Munellë, Lak-Rosh, Karma si dhe fabrika e pasurimit në Fushë Arrëz;
- Miniera e bitumit në Selenicë, miniera dhe furra e shkrirjes së bitumit në Vlorë.


Tabela 8 më poshtë paraqet prodhimin e mineraleve kryesore në Shqipëri nga viti 2007 deri në vitin 2013.

Tabela 8 – Prodhimi historik i mineralve sipas AKBN¹¹

Minerali	Njësia	2007	2008	2009	2010	2011	2012	2013
Krom	në '000 ton	202	225	284	328	350	360	521
Bakër	në '000 ton	98	105	114	140	305	480	508
Hekur-nikeli dhe nikel-silikat	në '000 ton	370	353	69	269	364	75	215
Qymyr	në '000 ton	4	2	2	-	1	1	-
Gur gelqeror	në '000 m ³	1,716	3,838	3,272	2,363	2,446	2,727	1,811
Argjilë	në '000 ton	765	649	796	795	973	961	768
Gips	në '000 ton	54	87	71	77	93	91	112

¹¹ Ky informacion është dërguar zyrtarisht nga AKBN tek Sekretariati ALBEITI dhe ky i fundit e prezantoi në këtë raport.

Figura 7 – Depozitat e gurëve dhe mineraleve jometalorë




2.3.1 Prodhimi i mineraleve në 2012

Prodhimi i raportuar nga të liçensuarit tek AKBN për vitin 2012 arriti shumën 149.2 milion USD (2011: 217,5 milion USD).

Grafiku 3 më poshtë paraqet prodhimin sipas mineralve kryesore në USD në vitin 2012 dhe 2011:


Grafiku 3 – Prodhimi mineral në USD në vitin 2012 dhe 2011



Prodhimi i kromit

Bazuar në të dhënat e raportuara nga AKBN prodhimi i kromit në 2011 ishte 92 milion USD ose 62% të prodhimit total në sektorin minerar (2011: 143 milion USD, 66% të prodhimit total në sektorin minerar). Ky prodhim është nxjerrë kryesisht nga minierat e Bulqizës në 58% të prodhimit të përgjithshëm kromit vitin 2012 (2011: 70% të prodhimit të përgjithshëm kromit).

Grafiku 4 – Shpërndarja e prodhimit të kromit sipas rajoneve prodhuese



Albchrome (ACR – më parë Albanian Chrome), i cili kryen aktivitetin në minierat e Bulqizës, ishte Shoqëria më e madhe nxjerrëse e kromit në Shqipëri në 2012. Në vitin 2012, Shoqëria prodhoi rreth 7% të prodhimit total të kromit (2011: 11%) dhe punësoi rreth 680 persona (2011: 690). Krahas Albchrome, shumë shoqëri të mesme dhe të vogla (më shumë se 200 liçensa) kanë nxjerrë krom nga Bulqizë, Tropojë, Has, Kukës, Mat etj.

Bazuar në të dhënat e raportuara nga AKBN, sektori i kromit kishte rreth 2,292 të punësuar në vitin 2012 (2011: 2190). Sektori i kromit në Bulqizë punësoi 77% të totalit të të punësuarve në sektorin e kromit në vitin 2012 (2011: 75%). Punësimi në Albchrome zinte rreth 30% të punësimit total në sektorin e kromit.

Tabela 9 – Të dhëna kryesore për prodhimin dhe punësimin

Rrethi	Prodhimi në ton			Të punësuar			Prodhimi për person	
	2012	2011	Ndryshimi %	2012	2011	Ndryshimi %	2012	2011
Bulqizë	244,011	433,053	-44%	1,776	1,651	8%	137 / 196(*)	262 / 385(*)
Tropojë	24,583	44,880	-45%	83	65	28%	296	690
Has	44,243	32,300	37%	25	36	-31%	1,770	897
Kukës	28,317	20,010	42%	136	162	-16%	208	124
Mat	36,918	59,200	-38%	121	115	5%	305	515
Të tjera	43,373	28,900	50%	151	161	-6%	287	180
Totali	421,445	618,343	-32%	2,292	2,190	5%	184 / 243(*)	282 / 370(*)*

* Shifrat janë ri-paraqitur pas zhveshjes së të dhënave nga efekti Albchome.

Pavarësisht rënies me 32% në prodhimin e kromit në vitin 2012 krahasuar me vitin 2011, punësimi në sektorin e kromit është rritur lehtë me 5%. Ndryshimet në trendin e prodhimit dhe të punësimit në këtë sektor nuk kanë korrelacion domethënës. Për më tepër, ky korelacion ndryshon në rrethe të ndryshme. Ky fakt, pjesërisht shpjegohet më përmirësimet teknologjike, por edhe me informalitetin në sektorin e prodhimit të kromit, ku shpesh mediat flasin për banorët e papunë që angazhohen në mbledhjen e xeherorit të kromit në afërsi të minierave të mbyllura.

Prodhimi i bakrit

Beralb ishte e vetmja shoqëri industriale në nxjerrjen e bakrit në vitin 2012 dhe 2011, me rreth 100% të vlerës së prodhimit të bakrit në vitin 2012 dhe 2011. Beralb zotëron liçensa prodhimi për minierat e Munellës, Lak Roshit, Karmës dhe Fushë Arrës, të gjitha të vendosura në krahinën e Pukës.

Prodhimi i përbërjeve të nikelit

Në vitin 2012, nikeli u prodhua kryesisht në formën e hekur-nikelit dhe nikel-silikatit në zonën e Librazhdit 56% (2011: 17%), Pogradecit 12% (2011: 28%), Kukësit 12% (2011: asnjë) etj. Në vitin 2011, rreth 56% të prodhimit të nikelit u raportua në Elbasan. Prodhimi në të dy vitet, u gjenerua nga shoqëri minerare të vogla dhe të mesme, si dhe disa të liçensuar që mbledhin nikelin nga shoqëritë e vogla dhe të mesme.

Prodhimi i gurit gëlqeror dhe mineraleve të tjera

Një numër i madh shoqëri të vogla vepronin në nxjerrjen e gurit gëlqeror dhe materialeve të tjera të ndërtimit në vend. Fushe-Kruja Cement Factory dhe Antea Cement, me veprimtari në Krujë, ishin prodhuesit më të mëdhenj me rreth 15% dhe 12% të prodhimit total të nikelit në vitin 2012.

2.4 Transparenca rreth procesit të licensimit dhe të liçensuarve

Një vështrim i përgjithshëm i situatës aktuale të liçensimit dhe zonat e lira për liçensim në kërkim dhe prodhim paraqitet përkatësisht në faqen e internetit të AKBN: www.akbn.gov.al dhe në faqen e Albpetrol www.albpetrol.al për liçensat e administruara prej tij.

Shoqëritë e interesuara mund marrin informacion mbi procesin në AKBN dhe të dorëzojnë aplikimet e tyre në çdo kohë. Ky process nuk ka tarifa.

Ministria e Energjisë dhe e Industrisë ka publikuar në faqen e saj të internetit: www.energija.gov.al, një regjistër për liçensat minerare të dhëna deri në korrik 2014, duke përfshirë informacion mbi: të liçensuarin, datën e dhënies së liçensës, produktin e prodhuar dhe sipërfaqen e zonës së dhënë.

Aktualisht, AKBN¹² po vendos në faqen e saj Sistemin Informatik Gjeografik ("GIS") i cili do të japë informacion të përditësuar mbi mbajtësit e liçensave, zonën në përdorim dhe koordinatat. Ky portal do të paraqes liçensat të dhëna në çdo zonë dhe zonat e lira.

Informacione mbi Shoqëritë e liçensuara dhe aksionarët e tyre gjendet në faqen zyrtare të Qendrës Kombëtare të Regjistrimit: <http://www.qkr.gov.al/nrc/default1.aspx>.

¹² Ky informacion është dërguar zyrtarisht nga MEI tek Sekretariati ALBEITI dhe ky i fundit e prezantoi në këtë raport.

2.5 Kërkesat për auditim në Shqipëri

Në Shqipëri, çdo shoqëri me përgjegjësi të kufizuar ("Ltd" ose "Sh.p.k"), me përjashtim të shoqërive të vogla, i nënshtrohet auditimit ligjor. Ligji mbi Auditimin nr. 10091, "Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të Ekspertit Kontabël të Regjistruar dhe të Kontabilistit të Miratuar", datë 5 mars 2009 e përkufizon si shoqëri të vogla, ato që përmbushin dy nga kriteret e mëposhtme:

- 1) Totali i aktiveve është më i vogël se 40 milion Lek
- 2) Kanë mesatarisht jo më shumë se 30 punonjës, dhe
- 3) Të ardhurat vjetore nuk i kalojnë 30 milionë Lek.

Shoqëritë me përgjegjësi të kufizuar që zgjedhin të raportojnë sipas SNRF-ve për qëllime statutore, janë subjekt i auditimit ligjor, pavarësisht kufizimeve të vendosura më sipër. Shoqëritë anonime ("JSC" ose "Sh.a.") janë subjekt i auditimit statutor, pavarësisht madhësisë së tyre.

Auditimi bazohet në ligje, rregullore, standarde dhe praktika auditimi përgjithësisht të pranuar në Shqipëri, duke përfshirë Standardet Ndërkombëtare të Auditimit. Pasqyrat financiare dorëzohen në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit (www.qkr.gov.al) deri më 31 korrik të vitit pasardhës kalendarik.

Nuk ka kërkesa të veçanta auditimi në lidhje shumat e raportimit EITI në Shqipëri.

Kontrolli i Lartë i Shtetit në Shqipëri (KLSH) kryen auditimin e aktiviteteve dhe llogarive të Shtetit. Auditimi kryhet në përputhje me ligjet dhe rregulloret e KLSH-së në faqen e tij të internetit: <http://www.klsh.org.al/>. Udhëzimet dhe standardet e auditimit bazohen në standardet e INTOSAI për auditimin e Qeverisë.



2.6 Industria nxjerrëse dhe kontributi i saj në ekonomi

2.6.1. Kontributi në ekonominë e vendit


Ekonomia shqiptare është e dominuar nga sektori i shërbimeve, duke përfshirë tregtinë, shërbimet e pasurive të patundshme, financiare, transport, postën dhe komunikimin etj.

Në periudhën 2008-2012, sektori i shërbimit së bashku përbënte mbi 50% të PBB-së vjetore.


Kontributi i sektorit nxjerrëse ndaj PBB-së u rrit nga 2.4% në vitin 2008 në 5.6% në vitin 2012.

Grafiku 5 në të majtë dhe grafiku 6 më poshtë paraqesin kontributin e sektorëve ekonomik ndaj PBB në vitin 2012 dhe në menyrë më specifike kontributin e sektorit nxjerrës nga viti 2008 deri në vitin 2012.

Grafiku 5 – PBB sipas sektorëve në vitin 2012



Grafiku 6 – Kontributi i industrisë nxjerrëse në PBB nga viti 2008 deri në vitin 2012



2.6.2. Të ardhurat e Qeverisë nga sektori i naftës, gazit dhe sektori mineral

Shteti shqiptar merr pjesën e tij nga vlera e krijuar nga industria nxjerrëse nëpërmjet:

- Tatimit të veprimtarisë hidrokarbure dhe minerare
- Taksave / tarifave dhe
- Dividendëve nga pronësia në Albpetrol Sh.a.

Lloji kryesor i të ardhurave që lidhen drejtpërdrejtë me sektorin nxjerrës janë paraqitur si më poshtë:

Renta minerare

Renta minerare i paguhet Shtetit për shfrytëzimin e burimeve natyrore. Renta minerare është e ardhura kryesore që merr shteti nga ky sektor. Renta minerare përlllogaritet mbi vlerën e tatueshme (ose vlerën fiskale) të të ardhurave nga aktiviteti i nxjerrjes, në bazë të ligjit "Për taksat kombëtare" nr. 9975, datë 28 korrik 2008, i ndryshuar. Renta minerare për eksportet mblihet nga Administrata Doganore Shqiptare dhe renta minerare nga shitjet brenda vendit mblihet nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve.

Sipas ligjit për taksat kombëtare, renta minerare nga shitja e naftës dhe gazit përlogaritet në 10% e vlerës së tatueshme, ndërsa për minralet e tjera renta varion nga 4% në 7%.

Tatimi mbi fitimin

Tatimi mbi fitimin mblidhet nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve si përqindje mbi të ardhurat neto të shoqërisë. Deri në dhjetor 2013, tatimi mbi fitimin në Shqipëri përlogaritej me 10% e fitimit të tatueshem në përputhje me "Ligjin për tatimin mbi të ardhurat" Nr. 8438, datë 28 Dhjetor 1998, ndryshuar. Më 1 Janar 2014, norma e aplikushme e tatimit mbi fitimin u rrit në 15%. Kërkesat e këtij ligji janë plotësisht të zbatueshme për sektorin minerar.

Tatimi mbi fitimin në sektorin hidrokarbur rregullohet nga Dekreti nr. 782 "Mbi sistemin fiskal në sektorin e hidrokarbureve", datë 22 dhjetor 1994 ("Ligji për tatimin e naftës").

Deri në Dhjetor 2011, sipas këtij ligji, tatimi mbi firmën përlogaritej në 30 - 55% mbi fitimin e tatueshëm bazuar në nivelin e prodhimit. Në 2012, ky dekret u ndryshua. Pas ndryshimit tatim fitimi përlogaritet në 50% mbi fitimin e tatueshëm. Sipas këtij ligji, në përlogaritjen e fitimit të tatueshëm merren parasysh të ardhurat dhe shpenzimet operative dhe kapitale të akumuluar siç përcaktohet në marrëveshjen hidrokarbura.

Në vitin 2011 dhe 2012, shoqëritë e naftës dhe gazit nuk paguan tatim mbi fitim, për shkak se shpenzimet e akumuluar ishin më të mëdha se të ardhurat e akumuluar sipas marrëveshjes hidrokarbure.

Bonuset e nënshkrimit

Bonuset e nënshkrimit dhe trajnimit janë terma pagese tipike të marrëveshjeve hidrokarbure. Ato përcaktohen (sipas negociatave të marrëveshjes) në momentin e dhënien e lejes të kërkimit ose prodhimit të naftës dhe gazit sipas termave dhe kushteve specifike të kontratës. Bonuset e nënshkrimit mblidhen nga Albpetrol (për nënshkrimin e liçensave të prodhimit) dhe AKBN (për nënshkrimin e lejeve të kërkimit).

Ndarja e prodhimit të naftës

Albpetrol zotëron pjesë nga nafta e prodhuar nga licensë-marrëveshjet nën administrimin e tij. Si rrjedhojë, Albpetrol ka të drejtë të përfitojë pjesë nga ndarja e prodhimit për prodhimin ekzistues dhe prodhimin e nxjerrë nga shoqëria e liçensuar, siç përcaktohet në marrëveshjen hidrokarbure. Ndarja nga prodhimi mund të paguhet në para ose në natyrë.

Në përputhje me marrëveshjen hidrokarbure, shoqëritë duhet t'i kalojnë Albpetrolit prodhimin ekzistues në masën 65 deri në 75% dhe pjesë nga prodhimi vetjak në masën 1 deri në 5%.

Interesat e Shtetit në industrinë nxjerrëse

Albpetroli është e vetmja shoqëri në industrinë nxjerrëse e zotëruar nga Shteti. Albpetroli është subjekt i tatimit dhe taksave të aplikueshme për shoqëritë tregtare të naftës si tatimi mbi fitimin, renta minerare, TVSH etj. Qeveria, gjithashtu ka të drejtë të përfitojë dividendët dhe të ardhurat nga privatizimi i Albpetrol.

Tabela 10 – Të dhëna financiare kryesore për Albpetrol¹³

<i>Në miliardë Lek, përveçse kur shprehet ndryshe¹⁴</i>	2011	2012
Totali i Aktiveve	71.7	71.5
Llogari të arkëtueshme	13.4	14.7
Inventarë	7.3	7.7
Kapitali dhe rezervat	62.5	58.4
Totali i detyrimeve	9.3	13.1
Të ardhura operative neto	9.3	8
Fitimi para tatimit	1.4	3.9
Prodhimi vetjak në '000 ton	44.4	59.9
Ndarja nga prodhimi në natyrë ('000 ton)	109.5	34.7
Ndarja nga prodhimi në para	-	2.1
Ndarja nga prodhimi mbledhur në total	5.1	3.6
Renta minerare paguar në vitet	0.98	0.4
Tatimi mbi fitimin paguar në vitet	0.5	0.2
Dividenti paguar në vitet	0.09	0.14

Në vitin 2012, Albpetrol raportoi total aktiveve prej 71.5 miliardë Lek (2011: 71.7 miliardë Lek), ku llogaritet e arkëtueshme dhe inventari zinin përkatësisht 21% dhe 11% të totalit të aktiveve (2011: 19% dhe 10% të aktiveve).

Shoqëria Albpetrol raportoi të ardhura operative neto në shumën 8.0 miliardë Lek (2011: 9.3 miliardë Lek) dhe fitim para tatimit në shumën 1.4 miliardë Lek ose 18% e të ardhurave operative neto (2011: 3.9 miliardë Lek ose 42% e të ardhurave operative neto). Albpetrol raportoi gjithashtu prodhimin vetjak në 44.4 mijë ton në vitin 2012 dhe 59.9 mijë ton në vitin 2011.

Të ardhurat nga ndarja e prodhimit

¹³ Ky informacion është dërguar zyrtarisht nga Albpetrol tek Sekretariati ALBEITI dhe ky i fundit e prezantoi në këtë raport.

¹⁴ Shumat e paraqitura më sipër bazohen në deklarinim të Albpetrol dhe mund të mos rakordojnë me shumat e tjera të paraqitura sipas Qeverisë në këtë raport, për shkak të mospërputhjeve të pazgjidhura midis Albpetrol dhe Qeverisë.

mbledhur në vitin 2012 ishin në shumën 5.1 miliardë Lek ose 55% e të ardhurave operative neto (2011: 3.6 miliardë Lek ose 45% e të ardhurave operative neto).

Renta minerare e paguar nga Albpetrol në vitin 2012 ishte 0.98 miliardë Lek ose 11% e të ardhurave operative, e përfaqësohet me normën e rentës prej 10% e aplikushme mbi shitjet e naftës bruto (2011: 0.4 miliardë Lek ose 5% e të ardhurave operative).

Përveç shpërndarjes së dividendit, nuk ka politika të tjera për transferimin e kapitalit ndërmjet Shtetit dhe Albpetrol.

Të ardhurat e Buxhetit të Shtetit (2008-2012)

Sistemet e informacionit të Shtetit nuk mund të prodhojnë informacion për të ardhurat total të ardhurat totale të gjeneruara nga industria nxjerrëse. Megjithatë, nëse konsiderojmë të ardhurat e gjeneruara nga taksat dhe tarifat kryesore të zbatueshme për industrinë si renta minerare, tatimi mbi fitimin, ndarja e prodhimit e naftës, bonuset nënshkrimit, dhe pagesa të tjera të lidhura me industrinë, të ardhurat nga industria nxjerrëse arrin 8.35 miliardë Lek ose 2.5% të ardhurave total në Buxhetin e Shtetit në vitin 2012 (referojuni tabelës 11 më poshtë).

Tabela 11 – Pasqyra e të ardhurave të qeverisë nga industria nxjerrëse

në miliardë Lek

Taksat dhe tarifat	2008	2009	2010	2011	2012
Renta minerare në eksport*	n/i	0.77	2.12	3.65	5.85
Renta minerare mbi shitjet brenda vendit	0.63	0.69	2.00	1.26	1.30
Bonuset e nënshkrimit	0.04	0.02	0.06	0.11	0.39
Dividenti paguar nga Albpetrol	0.04	-	-	0.15	0.10
Tatimi mbi fitimin paguar nga Albpetrol **	0.06	0.06	0.27	0.16	0.17
Tatimi mbi fitimin paguar nga sektori minerar***	n/i	n/i	n/i	0.74	0.53
Totali i të ardhurave kryesore	0.77	1.54	4.44	6.06	8.35
<i>n/i – nuk ka informacion</i>					
Totali i të ardhurave në Buxheti i Shtetit	290.90	299.00	319.60	330.40	337.20

Kontributi në Buxhetin e Shtetit në %	0.3%	0.5%	1.4%	1.8%	2.5%
---------------------------------------	------	------	------	------	------

* Administrata Doganore Shqiptare informon se nuk ka mbajtur në rentë minerare në eksport në vitin 2008, por nuk mund të prodhojë statistika për të ardhurat e mbledhura në këtë vit.

**Albpetroli ishte shoqëria e vetme e naftës që pagoi tatimin mbi fitimin gjatë periudhës 2008 – 2012.

***Drejtorja e Përgjithshme e Tatimeve raportoi vetëm tatimin mbi fitimin e paguar nga shoqëritë e përzgjedhura për vitin 2011 dhe 2012. Sistemet e informacionit të DPT nuk mund të prodhojnë statistikore për të gjithë sektorin. Rrjedhimisht, tatimi mbi fitimin nga sektori minerar prezantuar më lart nuk është e plotë.

Renta minerare është e ardhura kryesore nga industria nxjerrëse në Buxhetin e Shtetit. Ajo përfaqëson 86% e të ardhurave kryesore nga industria nxjerrëse në vitin 2012 prezantuar më sipër (2011: 81%).

Tabela 12 – Renta dhe prodhimi

<i>Shumat në miliardë Lek, përveçse kur shprehet ndryshe</i>	2011	2012
Renta mbledhur në total	4.91	7.15
<i>sektori i hidrokarbureve</i>	4.30	6.42
<i>Sektori minerar</i>	0.61	0.73
Prodhimi në total	70.77	65.85
<i>sektori i hidrokarbureve</i>	47.93	50.34
<i>Sektori minerar</i>	22.84	15.52
Renta / Prodhimi	6.9%	10.9%
<i>sektori i hidrokarbureve</i>	9.0%	12.8%
<i>Sektori minerar</i>	2.7%	4.7%

Totali i rentës së mbledhur në vitin 2012 u raportua në shumën 7.15 miliardë Lek (2011: 4.91 miliardë Lek), nga e cila shuma prej 6.4 miliardë Lek ose 90% u pagua nga sektori hidrokarbur (2011: 4.3 miliardë ose 88%). **Renta e paguar nga sektori hidrokarbur përbën 12.8% të prodhimit hidrokarbur në vitin 2012 (2011: 9%).**

Sektori minerar pagoi rentë në shumën 0.73 miliardë Lek që përbën 10% e totalit të rentës së mbledhur në vitin 2012 (2011: 0.61 miliardë Lek ose 12%). **Renta e paguar nga sektori minerar përbën 4.7% të prodhimit minerar në vitin 2012 (2011: 2.7%).**

2.6.3 Transfertat e rentës minerare tek qeverisja vendore

Renta minerare e arkëtuar nga shitja e naftës, gazit dhe mineraleve regjistrohet e gjitha në Buxhetin Shtetit. Në bazë të ligjit “Për taksat kombëtare”, nr. 9975, datë 28 korrik 2008, i ndryshuar, 25% e rentës minerare të mbledhur do të shpërndahet tek njësitë e qeverisjes vendore (NjQV) në raport me kontributin e tyre, sipas kushteve të ligjit vjetor për buxhetin. **Renta minerare e transferueshme, përlogaritur si 25% të shumës totale të të rentës minerare, ishte 1,788 milion Lek në vitin 2012 (2011: 1,226 Lek milion).**


Në vitin 2012, ligji për buxhetin vjetor e kufizoi shpërndarjen e rentës deri në 20% të transfertës së pakushtëzuar. Në këto kushte NjQV-të mund të përfitojnë nëse pjesa e tyre prej 25% e rentës së transferueshme, e tejkalon transfertën e pakushtëzuar përlogaritur sipas ligjit për buxhetin nga 101% deri në 120% të transfertës së pakushtëzuar. Si rrjedhim, pjesa e transferueshme varion nga 1% në 20% të transfertës së pakushtëzuar.

Në vitin 2013 pjesa e rentës së transferueshme u rrit në 50% të transfertës së pakushtëzuar. Në vitin 2014 ligji për transferimin e rentës minerare u ndryshua përsëri duke rritur pjesën e transferueshme të rentës së gjeneruar nga sektori minier deri në 80% të transfertës së pakushtëzuar. Në 4 nëntor 2014, Parlamenti Shqiptar prezantoi ndryshimet draft në Ligjin për taksat kombëtare për transferimin e rentës tek qeverisja vendore. Sipas këtyre ndryshimeve NjQV-të do të përfitojnë 5% të rentës së gjeneruar nga shoqëritë që operojnë në secilën NjQV panëvarësisht nga transfertat e parashikuara në përputhje me ligjin vjetor të buxhetit. Ligji vjetor për buxhetin pritet të reflektoje këtë ndryshim në ditët në vijim.

Sipas Ministrisë së Financave, të ardhurat nga renta minerare në vitin 2011 dhe 2012 ishin regjistruar në buxhetin e Shtetit në grup dhe nuk janë mbajtur regjistrime të sakta mbi rentën e gjeneruar nga secila njësi e qeverisjes vendore.

Ministria e Financave raportoi se nuk është bërë asnjë transferim rente ndaj NjQV-ve gjatë vitit 2011. Në vitin 2012, transferimet për rentën minerare arritën shumën **41.7 milion Lek, që përbëjnë 0.6% të rentës së mbledhur në total ose 2.3% e totalit të rentës se tranferueshme** në përputhje me Ligjin për taksat kombëtare. Per më tepër, vetëm disa NjQV që prodhojnë naftë arritën të përfitojnë nga transfertat e rentës:

Grafiku 7 – Transfertat e rentes ne vitin 2012



2.6.4 Shpenzimet e Qeverisë

Tabela 13 – Pasqyra e shpenzimeve të Qeverisë

Shpenzimet e qeverisë në miliardë Lek	2008	2009	2010	2011	2012
Shpenzimet operative	253	282.9	299.9	305.6	316.7
Shpenzimet kapitale	93.8	101.4	71.6	70.6	60.0
Totali	346.8	384.3	371.5	376.2	376.7
Shpenzimet e personelit	19%	16%	18%	18%	19%
Fondi për sigurimet shoqërore	22%	26%	29%	30%	32%
Shpenzimet kapitale	27%	26%	19%	19%	16%
Të tjera	32%	32%	34%	33%	33%
Totali	100%	100%	100%	100%	100%

Shpenzimet e personelit dhe fondi për sigurimet shoqërore përfaqësojnë shpenzimet kryesore në buxhetin e Shtetit. Fondi për sigurimeve shoqërore tregon një tendencë në rritje, e cila i atribuohet rritjes së pensionit të përfituar dhe numrit të përfituesve. Shpenzimet kapitale janë ulur nga 27% në 16%.

Ministria e Financave nuk ka dhënë informacion mbi shpërndarjen e të ardhurave nga industria nxjerrëse ose alokimi i tyre për ndonjë kategori shpenzimesh apo program të caktuar. Megjithatë, kontributi i matshëm nga industria nxjerrëse është rreth 2.5% të të ardhurave totale dhe nuk është kontribues kryesor në financat e buxhetit të shtetit.

2.6.5 Eksportet nga industria nxjerrëse

Eksportet industria nxjerrëse janë rritur ndjeshëm në tre vitet e fundit me mbi 100%.

Në vitin 2012, eksportet nga industria nxjerrëse arritën vlerën 75 miliardë Lek ose 34% e të totalit të eksporteve (2011: 49 miliardë Lek, ose 25% të totalit të eksporteve).

Kjo rritje e konsiderueshme i atribuohet eksporteve të naftës të cilat janë trefishuar në tre vitet e fundit. Në vitin 2012, eksportet e naftës përfaqësonin 71% të totalit të eksporteve nga industria nxjerrëse në vlerën 53 miliardë Lek (2011: 32 miliardë lekë, 64% e eksporteve të industrisë nxjerrëse).


Gjatë pesë viteve të fundit nafta u eksportua kryesisht në vendet e Evropës Perëndimore, ku Itala ishte desitacioni kryesor i ekportit të naftësë përgjatë pesë viteve.

Në 2010 nisën eksportet drejt Spanjës dhe Maltës dhe në vitin 2012 drejt Gjermanisë.

In 2012, 53% e naftës u ekportuar drejt Italisë, pasuar nga Spanja me 34%, Malta me 7% dhe Gjermania me 4%.

Tabela 14 në të djathtë paraqet eksportin kumulativ të naftës gjatë viteve 2008-2012 dhe drejt destinacioneve kryesore.

Grafiku 8 – Eksportet nga industria nxjerrëse krahasuar me eksportet ne total



Grafiku 9 – Eksportet nga industria nxjerrëse sipas mineralve




Tabela 14 – Cumulative exports value by major destination countries for the period 2008 - 2012

Destinacionet	Eksportet kumulative në miliardë Lek (2008-2012)	Periudha
Itali	70	2008-2012
Spanjë	28	2010-2012
Maltë	9	2010-2012
Gjermani	2	2012
Të tjera	5	
Total	115	

Eksportet nga sektori minerar në total arrijnë vlerën 21.7 miliardë Lek në vitin 2012 ose 29% të totalit të eksporteve nga industria nxjerrëse (2011: 18 miliardë lekë, 36% të totalit të eksporteve nga industria nxjerrëse).


Eksportet e kromit, ku përfshihet xeherori i kromit, koncentrat i kromit dhe ferrokromi arritën vlerën 9.3 miliardë¹⁵ Lek ose 12% të totalit të eksporteve nga industria nxjerrëse (2011: 11.5 miliardë Lek ose 23% të totalit të eksporteve nga industria nxjerrëse). Eksportet e ferrokromit raportohen të jenë 4 miliardë Lek në vitin 2012 (2011: 6.3 miliardë Lek). Sipas Administratës Doganore Shqiptare eksportet e kromit në vitin 2012 përllogariten në 455 mijë ton (2011: 375 mijë ton).

Në dy vitet e fundit të kromi u eksportuar kryesisht në Kinë, Hollandë, Austri, Zvicër etj. Megjithatë, Kina përfaqësonte destinacionin kryesor të eksportit të kromit përgjatë gjithë periudhës pesëvjeçare nga viti 2008 deri në 2012.

Eksportet e bakrit, përfshirë koncentratin e bakrit arritën vlerën 5.5 miliardë Lek në vitin 2012 ose 8% të totalit të eksporteve të industria nxjerrëse (2011: Lek 4.2 miliardë, ose 8% të totalit të eksporteve industria nxjerrëse). Sipas Administratës Doganore Shqiptare eksportet e bakrit në vitin 2012 përllogariten në 90 mijë ton (2011: 36.5 mijë ton).

Eksportet e bakrit kishin si destinacion kryesor Turqinë dhe Kinën.

Figura 8 – Destinacionet kryesore të eksportit të naftës:



¹⁵ Ky informacion është dërguar zyrtarisht nga Administrata Doganore Shqiptare tek Sekretariati ALBEITI dhe ky i fundit e prezantoi në këtë raport.

Bilanci tregtar i naftës

Tabela 15 më poshtë paraqet një përmbledhje të sasisë së prodhuar të naftës bruto, sasisë së eksportuar dhe një krahasim midis prodhimit dhe eksportit si dhe prodhimit dhe konsumit të brendshëm..

Tabela 15 – Raporti i pavarësisë së naftës (2008 – 2012)

Në mijë ton

Viti	Naftë bruto e prodhuar	Naftë bruto e eksportuar	Eksport / prodhim	Naftë bruto e konsumuar ¹⁶	Prodhim / konsum
2008	578	277	48%	1,325	44%
2009	577	370	64%	1,209	48%
2010	744	571	77%	1,207	62%
2011	895	751	84%	1,172	76%
2012	1,029	1,024	100%	1,044	99%

Burimi: INSTAT dhe Adminstrata Doganore Shqiptare

Nafta bruto e prodhuar përfaqëson 44% të kërkesave vendase për naftë bruto në vitin 2008. Për shkak të rritjes së veprimtarisë së shoqërive private në sektorin e prodhimit të naftës bruto, ky raport është rritur ndjeshëm që nga viti 2008. Në 2012 nafta bruto e prodhuar barazon nevojat për konsum me rreth 99%. Nëse e gjithë nafta bruto e prodhuar në vend do të rafinohej po në vend, prodhimi vendas do të ishte mjaft afër plotësimit të kërkesës për konsum në vend.

2.6.6 Punësimi në industrinë nxjerrëse

Industria nxjerrëse kërkon investime të larta kapitale dhe më pak punonjës krahasuar me sektorët e tjerë të ekonomisë si shërbimet. Bazuar në të dhënat e raportuara nga AKBN, industria nxjerrëse (duke përfshirë edhe Alpertolin) punëson rreth **7,800 punonjës** në vitin 2012 (2011: 8500). Punësimi në industrinë nxjerrëse përfaqëson **0.78% të punësimit të përgjithshëm** (2011: **0.82%**). Reduktimi me rreth 600 punonjës i atribuohet plotësisht sektorit mineral, ku punësimi u ul me 19%.

Kjo rënie u shfaq kryesisht në mineralet e gurit gëlqeror dhe të tjera jometalore të cilat përbëjnë një burimin kryesor për sektorin e ndërtimit. Kjo shpjegohet me trendin rënës në industrinë e ndërtimit në vitin 2012.

¹⁶ Ky term mat sasinë e naftës bruto duke përfshirë atë që rafinohet në vend dhe naftën e importit. Ky informacion është dërguar zyrtarisht nga INSTAT tek Sekretariati ALBEITI dhe ky i fundit e prezantoi në këtë raport.

3. Pamje e përgjithshme e flukseve të raportuara dhe e shoqërive raportuese

3.1 Pagesat e përfshira në rakordim

Bazuar në rëndësinë e të ardhurave nga industria nxjerrëse për Buxhetin e Shtetit, MSG përcakton tipet e ardhurave për t'u përfshirë në raportim. Në vijim, shoqëritë e liçensuara do të raportojnë të gjitha pagesat e bëra për tipet e përcaktuara në vitin 2012 në lidhje me veprimtarinë hidrokarbure dhe minerare. MSG, nëpërmjet termave të referencës për raportimin EITI, ka specifikuar të ardhurave që do rakordohen:

Figura 9 - Flukset e parasë për t'u raportuar nga të liçensuarit dhe dhe entet shtetërore arkëtuese

Të liçensuarit	Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve	Administrata Doganore Shqiptare	Ministria e Energjisë dhe Industrisë	Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore	Albpetrol
Pagesat nga: Të gjitha shoqëritë (përfshirë Albpetrol-in) 1. Renta minerare 2. Tatimi mbi fitimin 3. Tatimi mbi dividendin 4. Penalitetet tatimore 5. Pagesa të tjera materiale (nëse ka) Nafta dhe gazi (vetëm) 6. Bonuset e nënshkrimit 7. Pjesë nga ndarja e prodhimit paguar Albpetrol-it Albpetroli (vetëm) 8. Dividentët paguar MEI	Arkëtimet nga: 1. Renta minerare (shitjet e brendshme) 2. Tatimi mbi fitimin 3. Tatimi mbi dividendin 4. Penalitetet tatimore 5. Pagesa të tjera materiale (nëse ka)	Arkëtimet nga: 1. Renta minerare (eksportet) 5. Pagesa të tjera materiale (nëse ka)	Cash flow collected: 8. Dividentët nga Albpetrol 5. Pagesa të tjera materiale (nëse ka)	Cash flow collected: 6. Bonuset e nënshkrimit 5. Pagesa të tjera materiale (nëse ka)	Cash flow collected: 6. Bonuset e nënshkrimit 7. Pjesë nga ndarja e prodhimit paguar shoqëritë e naftës 5. Pagesa të tjera materiale (nëse ka)

Në Shqipëri, MSG (nëpërmjet termave të referencës) ka përjashtuar pagesat që nuk janë të lidhura në mënyrë direkte me aktivitetin e naftës, gazit dhe mineraleve ose që nuk janë paguar ndaj Shtetit.

Rrjedhimisht, taksat indirekte si TVSH ose taksat doganore nuk janë përfshirë në raportim. TVSH është një tatim i përgjithshëm mbi konsumin dhe aplikohet për një shumëllojshmëri mallrash dhe shërbimesh. Në mënyrë të ngjashme, taksat e importit dhe ato vendore janë të përgjithshme në natyrë dhe aplikohen ndaj të gjitha industrive. Këto taksa dhe tarifa janë të njëjta për të gjitha industritë dhe nuk aplikohet ndonjë tarifë e veçantë për shoqëritë që operojnë në industrinë nxjerrëse.

Pagesat sociale

U kërkua që shoqëritë të raportonin pagesat sociale të kryera në shumën mbi 5 milion Lek. Këto pagesa u pranuan si deklarime të njëanëshme dhe nuk u kërkua të rakordimi me deklarimin e marrësit të pagesës.

Pagesat në natyrë

Të liçensuarit duhet të raportonin të gjitha kontributet e dhëna në natyrë Shtetit ose shoqërive të zotëruara prej tij.

Pagesat e tjera

Shoqëritë duhet të raportonin pagesat e tjera veçantë nëse këto ishin më të larta se 50,000 USD (ekuivalente me 5,000,000 Lek) për pagesa të bëra ndaj Shtetit dhe 5,000 USD (ekuivalente me 50,000 Lek) për pagesa të bëra ndaj NJQV-ve.

3.2 Përzgjedhja e të liçensuarve për raportim

MSG dhe EITI Shqipëri përzgjedhën 78 shoqëri raportuese, duke përfshirë:

- Të gjitha shoqëritë e naftës që operonin në vitin 2012, përkatësisht 8 shoqëri private dhe Albpetrol; si dhe
- 69 shoqëri minerare dhe të sektorit të karrierave nga 455 liçensa aktive të raportuara nga AKBN në vitin 2012.

Në sektorin mineral, u përzgjedhën të gjitha shoqëritë minerare që operonin një liçensë kërkimi (6 të liçensuar në vitin 2012) dhe prodhuesit më të mëdhenj sipas kritereve të mëposhtme:

1. Përzgjedhja përfshin të gjitha Shoqëritë që kanë raportuar të ardhura të barabarta ose më të mëdha se 750,000 USD dhe
2. Për secilin mineral u aplikuan nën-kriteret e mëposhtme për zgjedhjen e shoqërive raportuese:
 - ✓ Për nën-sektorin e kromit, përzgjedhja përfshiu të gjitha shoqëritë që raportuan prodhim më të madh se 2.000 ton në vit;
 - ✓ Për nën-sektorin e bakrit, përzgjedhja përfshiu të gjitha shoqëritë që kanë raportuar më shumë se 100 ton prodhim në vit;
 - ✓ Për nën-sektorin e nikelit, të gjitha shoqëritë që kanë raportuar më shumë se 5.000 ton prodhim në vit;
 - ✓ Për nën-sektorët e bitumit dhe rërës së bitumit, gurit gëlqeror, të gjitha shoqëritë që kanë raportuar më shumë se 50,000 ton prodhim në vit.


Përkrah të liçensuarve, katër institucione qeveritare dhe Albpetrol kanë deklaruar flukse monetare të arkëtuara nga shoqëritë e liçensuara.

4. Qasja, metodologjia dhe puna e kryer

4.1 Proçesi i përgjithshëm

Proçesi i rakordimit për raportimin EITI konsiston në hapat e mëposhtëm:

- Mbledhja e pagesave të detajuara për rakordim nga institucionet qeveritare dhe të liçensuarit;
- Krahasimi i shumave të raportuara nga institucionet qeveritare dhe të liçensuarit për të përcaktuar nëse ka mospërputhje ndërmjet shumave që raportojnë institucionet qeveritare si të arkëtuara dhe shoqëritë e liçensuara si të paguara;
- Komunikimi me institucionet qeveritare dhe shoqëritë e liçensuara për të sqaruar mospërputhjet;
- Rakordimi i shumave të raportuara me informacione të tjera publike, duke përfshirë llogaritë e Buxhetit të Shtetit (kur kjo është e mundur);
- Përgatitja e raportit draft duke përmbledhur rezultatet e punës dhe mësimet e nxjerra, përfshirë rekomandimet për përmirësim dhe zbatimin e rekomandimeve të vitit të mëparshëm;
- Marrja e komenteve nga palët e interesuara mbi raportin draft;
- Raportimi përfundimtar.



4.2 Mbledhja e të dhënave

Më 9 maj 2014 dhe 25 korrik 2014, EITI Shqipëri organizoi në një seminar orientimi për të gjitha shoqëritë pjesëmarrëse në raportimin EITI 2011 dhe 2012. Deloitte bëri një prezantim të plotë të procesit të rakordimit të EITI-t dhe llojeve të të ardhurave që do të rakordohen. Udhëzimet për raportimin e vitit 2011 dhe 2012 u shoqëruan me kërkesën zyrtare nga MEI duke u kërkuar pjesëmarrësve të raportojnë brenda afatit të përcaktuar dhe të bashkëpunojnë me Deloitte gjatë rakordimit dhe hetimit të mospërputhjeve. Formularët e deklarimit të pagesave iu shpërndanë pjesëmarrësve në seminar nëpërmjet CD-ve dhe postës elektronike. Subjekteve iu kërkuar të raportojnë dhe të drejtojnë pyetje në lidhje me formularët e deklarimit direkt tek administratori, Deloitte.

EITI Shqipëri i mbështetur nga Ministria e Energjisë dhe Industrisë u dërgoi kërkesa zyrtare të gjitha institucioneve dhe agjencive qeveritare raportuese për pjesëmarrje në procesin e raportimit EITI. Me qëllim që të përshpejtohej hartimi i databazave dhe procesi i rakordimit, MEI u kërkoj të liçensuarve dhe institucioneve qeveritare raportuese të dorëzojnë deklarimet elektronike nëpërmjet postës elektronike më 31 korrik 2014 dhe më pas të dorëzojnë raportimin zyrtar të nënshkruar deri më 8 gusht 2014.

Të liçensuarit raportuan pagesat e tyre në periudhën ndërmjet 31 korrik dhe 15 tetor 2014. Institucionet qeveritare raportuan pagesat e arkëtuara në periudhën nga 10 shtator deri më 10 tetor 2014. Deloitte informoi AlbEITI-n çdo ditë mbi statusin e procesit të raportimit. Shoqëritë dhe institucionet qeveritare u kontaktuan dhe rikujtuan për kërkesat e raportimit.

Institucionet shtetërore dhe 78 të Liçensuar duhet të raportinin për vitin 2012, nga të cilët 74 Shoqëri kanë raportuar deri në datën e këtij raporti.

4.3 Formularët e raportimit

MSG and ALBEITI kanë hartuar formularë standard për deklarimin e pagesave për të lehtësuar raportimin nga shoqëritë e liçensuara dhe institucionet qeveritare. Këto formularë janë përshtatur për të përfshirë flukset më të rëndësishme të parasë siç paraqiten në figurën 9.

4.4 Proçedurat e kryera

Proçesi i hartimit të raportimit dhe zgjidhjes së mospërputhjeve është kryer nga Deloitte në periudhën nga data 10 shtator deri më 15 tetor 2014.

Deloitte ka kryer proçedurat e mëposhtme për shumat e raportuara:

- Shifrat e raportuara nga shoqëritë e liçensuara janë krahasuar zë për zë me shifrat e raportuara nga institucionet qeveritare, kur kjo u mundësua. Në bazë të këtij krahasimi, mospërputhjet janë përcaktuar zë për zë për secilin nga shoqëritë e liçensuara.
- Nëse raportimi nga institucionet qeveritare përputhej me raportimin nga shoqëritë e liçensuara, shifrat e institucionet qeveritare janë konsideruar të konfirmuara nga raportimi i të liçensuarit dhe nuk është konsideruar e nevojshme që këto shifra të ndiqeshin më tej.
- Në rastet mospërputhje, shoqëritë e liçensuara janë kontaktuar për sqarime të mëtejshme. Deloitte ka dhënë informacion nëse mospërputhjet lidhen me taksat ose tarifat, apo me shumat të cilat nuk janë raportuar nga njëra palë.
- Shoqërive të liçensuara u është kërkuar të ofrojnë detaje të shumave (data dhe përshkrime). Në shumicën e rasteve kjo ka ndihmuar në shpjegimin e mospërputhjeve. Kur shoqëritë raportuese nuk arrinin të gjenim arsye për mospërputhjet u kontaktuan institucionet qeveritare dhe u kërkuan detaje mbi flukset e parasë.
- Rezultatet e punës më sipër dhe komentet dhe rekomandimet për përmirësimin e proçesit u përmbledhën në raportin draft.
- Komentet e MSG dhe EITI Shqipëri u reflektuan në raportin draft;

Standardi EITI nuk ka materialitet për shpjegimin e mospërputhjeve. Si rrjedhojë, të gjitha devijimet që mund të shpjegohen, duhet të shpjegohen pavarësisht nga materialiteti i tyre.

Për shkak se llogaritë e të ardhurave në Buxhetin e Shtetit nuk paraqiten të ndara sipas industrive, ne nuk mundëm të krahasonim flukset e raportuara nga kjo industri me llogaritë e publikuara të Buxhetit të Shtetit në vitin 2012.

Ky proçes nuk konfirmon që nuk ka patur pagesa të tjera që i janë bërë Shtetit përveç atyre të raportuara, duke qenë se këto shuma mund të mos jenë raportuar nga të liçensuarit dhe institucionet shtetërore njëkohësisht.

Rregullimi aktual i EITI nuk kërkon që ne të kryenim testime të detajuara për të zbuluar nëse ka shuma të paraportuara; dhe zbulimi i shumave të paraportuara do të ishte i vështirë edhe nëpërmjet testimi të detajuar të të gjitha shoqërive të liçensuara.

Rezultati i proçedurave tona paraqitet në kapitullin 6.

5. Përmbledhja e rakordimit

Tabela 16 - Përmbledhja e rakordimit të pagesave që shkojnë në Buxhetin e Shtetit

Shumat në mijë Lek	Raportimi fillestar			Korrigjimi		Shumat e korigjuara		
	Të liçensuarit	Qeveria	Mospërputhja	Të liçensuarit	Qeveria	Të liçensuarit	Qeveria	Mospërputhja
I. Sektori i naftës dhe gazit	6,944,703	5,842,180	1,102,523	(1,110,726)	(8,203)	5,833,977	5,833,977	-
II. Sektori minerar	1,003,227	990,753	12,474	(9,965)	(1,931)	993,262	988,822	4,440
III. Albpetroli	1,892,118	1,901,374	(9,257)	(3,376)	-	1,888,742	1,901,374	(12,633)
TOTALI	9,840,048	8,734,307	1,105,740	(1,124,067)	(10,134)	8,715,981	8,724,174	(8,193)

Tabela 17 - Përmbledhja e rakordimit të pagesave ndaj Albpetrol

Shumat në mijë Lek	Raportimi fillestar			Korrigjimi		Shumat e korigjuara		
	Të liçensuarit	Albpetrol	Mospërputhja	Të liçensuarit	Albpetrol	Të liçensuarit	Albpetrol	Mospërputhja
I. Sektori i naftës dhe gazit	5,478,496	5,142,769	335,727	-	272,268	5,478,496	5,415,037	63,459
TOTALI	5,478,496	5,142,769	335,727	-	272,268	5,478,496	5,415,037	63,459

6. Rakordimi i pagesave të raportuara

Ky kapitull paraqet rakordimin e pagesave nga të liçensuarit e naftës dhe gazit, shoqëritë e përzgjedhura minerare në Buxhetin e Shtetit, si dhe rakordimin e pagesave të mbledhura nga Albpetrol dhe kontributin e këtij të fundit në Buxhetin e Shtetit.

6.1 Rakordimi i pagesave përmbledhëse në Buxhetin e Shtetit nga sektori i naftës dhe i gazit

Tabela 18 - Përmbledhja e pagesave nga sektori i naftës dhe të gazit në Buxhetin e Shtetit

Shumat në mijë Lek

Pagesat në total	Raportimi fillestar	Mospërputhja e zgjidhur		Pa kundërparti	Shuma e korigjuar
		Paguesi	Arkëtusi		
Të liçensuarit	6,944,702	(1,110,725)	-	-	5,833,977
Qeveria	5,842,181	-	(8,204)	-	5,833,977
Mospërputhja	1,102,521	(1,110,725)	8,204	-	-

Në total, 8 shoqëri hidrokarbure duhet të raportojnë pagesat e bëra në Buxhetin e Shtetit, përkatësisht 4 të liçensuar në prodhim dhe 5 në kërkim. Bankers Petroleum zotëron të dy liçensat, prodhim dhe kërkim. Ne morëm deklarime nga të gjitha shoqëritë hidrokarbure.

Të gjitha mospërputhjet u shpjeguan nëpërmjet rakordimit. Një përmbledhje e flukseve dhe rakordimit është paraqitur më poshtë në rakordimin sipas llojit të të ardhurave.

Tabela 19 - Përmbledhja e rakordimit të pagesave nga sektori i naftës dhe të gazit në Buxhetin e Shtetit – sipas llojit të të ardhurave

Shumat në mijë Lek

Lloji i të ardhurave	Shuma e paguesit	Shuma e arkëtuesit	Mospërputhja e zgjidhur		Mospërputhja e pazgjidhur	Pa kundërparti
			Paguesi	Arkëtuesi		
Renta minerare - në eksport	5,115,989	5,104,242	(11,747)	-	-	-
Renta minerare - shitjet brenda vendit	130,673	347,363	(5,461)	(222,151)	-	-
Penaltitet	1,307,407	648	(1,092,811)	213,948	-	-
Bonuset e nënshkrimit	390,634	389,927	(707)	-	-	-
Totali	6,944,703	5,842,180	(1,110,726)	(8,203)	-	-

Renta minerare është fluksi më i madh i parasë paguar nga sektori i naftës dhe i gazit në Buxhetin e Shtetit. Ky fluks zë përkatësisht 93% të pagesave totale të raportuara në tabelën 19 më sipër.

Në rast eksporti të liçensuarit depozitojnë parapagimet për rentën në llogari të Autoritetit Doganor. Renta mbahet nga kjo llogari në datën e eksportit. Të ardhurat e Shtetit regjistrohen në datën e eksportit. Përpara kësaj date shumat e depozituara i përkasin shoqërisë. Për këtë arsye parapagimet nuk konsiderohen si të ardhura deri në momentin që ato përdoren për pagesën e rentës në eksport.

Dy shoqëri prodhimi kanë kontributin më të madh në flukset e parasë të derdhura në Buxhetin e Shtetit, përkatësisht Bankers Petroleum me 93% dhe Stream Oil and Gas me 6%,

Bankers Petroleum raportoi pagesa sociale për vitin 2012 në përfitim të komunitetit përreth në shumën 28 milion Lek. Këto pagesa u pranuan në mënyrë të njëanëshme. Asnjë shoqëri tjetër nuk raportoi pagesa të kryera në përfitim të komunitetit në vitin 2012.

Çështje të tjera të lidhura me raportimin

Deri në datën e këtij raporti, të gjithë të liçensuarit dorëzuan formularët e nënshkruar dhe autorizimin për publikimin e të dhënave, përkrah raportimit elektronik të dërguar në fillim me postë elektronike.

6.1.1 Renta minerare – Sektori i naftës dhe i gazit

Renta minerare përlogaritet në masën 10% mbi të ardhurat e tatueshme nga shitja e naftës dhe e gazit. Renta minerare për eksportet mbledhet nga Administrata Doganore Shqiptare dhe renta minerare për shitjet brenda vendit mbledhet nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve.

Tabela 20 - Përmbledhja e rakordimit të rentës minerare për eksportet – nafta dhe gazit

Shumat në mijë Lek

Pagesat në total	Raportimi fillestar	Mospërputhja e zgjidhur		Pa kundërparti	Shuma e korigjuar
		Paguesi	Arkëtuesi		
Të liçensuarit	5,115,989	(11,747)	-	-	5,104,242
Administrata Doganore Shqiptare	5,104,242	-	-	-	5,104,242
Mospërputhja	11,747	(11,747)	-	-	-

Vetëm 2 nga 4 të liçensuarit në prodhim raportuan pagesa të rentës minerare për eksportet.

Mospërputhja prej 11,747 mijë Lek rezultoi si rrjedhojë e raportimit nga shoqëritë e liçensuara të parapagimeve, në vend të rentës së paguar.

Nuk ka mospërputhje të pazgjidhura nga rakordimi i paraqitur më sipër. Një pamje e detajuar për çdo shoqëri është paraqitur në Shtojcën 1.

Tabela 21 - Përmbledhja e rakordimit të rentës minerare për shitjet brenda vendit - sektori i naftës dhe gazit

Shumat në mijë Lek

Pagesat në total	Raportimi fillestar	Mospërputhja e zgjidhur		Pa kundërparti	Shuma e korigjuar
		Paguesi	Arkëtuesi		
Të liçensuarit	130,673	(5,461)	-	-	125,212
Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve	347,363	-	-	-	347,363
Mospërputhja	(216,690)	(5,461)	-	-	(222,151)

Vetëm 2 nga 4 të liçensuarit në prodhim raportuan pagesa të rentës për shitjet brenda vendit.

Autoritetet tatimore nuk raportuan pagesën prej 5,461 mijë Lek, për të cilën shoqëria e liçensuar na siguroi dokumentin mbështetës të pagesës me përfitues Drejtorinë e Tatimeve. Autoritetet tatimore na informuan se për shkak të kufizimeve në sistemet e tyre të raportimit, nuk mund të japin siguri mbi plotësinë e rentës minerare të raportuar për secilën shoqëri.

Nuk ka mospërputhje të pazgjidhura nga rakordimi i paraqitur më sipër. Një pamje e detajuar për çdo shoqëri është paraqitur në Shtojcën 1.

6.1.2 Penalitetet tatimore – sektori i naftës dhe gazit

Këtë vit, u kërkua që të liçensuarit të raportonin pagesat për penalitetet tatimore të paguara në lidhje me taksat dhe tarifet e përfshira në këtë rakordim.

Tabela 22 – Përmbledhje e rakordimit të penaliteteve tatimore - sektori i naftës dhe gazit

Shumat në mijë Lek

Pagesat në total	Raportimi fillestar	Mospërputhja e zgjidhur		Pa kundërparti	Shuma e korigjuar
		Paguesi	Arkëtuesi		
Të liçensuarit	1,307,407	(1,092,811)	-	-	214,596
Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve	648	-	213,948	-	214,596
Mospërputhja	1,306,759	(1,092,811)	(213,948)	-	-

Vetëm 2 nga 8 të liçensuarit raportuan penalitete tatimore. Nga rakordimi i raportimit fillestar, u identifikuan mospërputhje në 2 raste. Në të dy rastet mospërputhjet u shpejguan nga investigimi i mëtejshëm. Këto mospërputhje erdhën sepse të liçensuarit raportuan pagesa të penaliteteve për TVSH-në dhe taksat të tjera që nuk ishin përfshirë në rakordimin e vitit 2012.

6.1.3 Bonuset e nënshkrimit

Bonuset e nënshkrimit përcaktohen herë pas here bazuar në negociatat e marrëveshjes për lejen e kërkimit ose prodhimit të naftës dhe gazit sipas termave dhe kushteve specifike të kontratës. Bonuset e nënshkrimit mbledhen nga Albpetrol (për liçensat e prodhimit) dhe AKBN (për liçensat e kërkimit).

Bonuset e nënshkrimit të mbledhura nga AKBN janë si më poshtë:

Tabela 13 - Përmbledhja e rakordimit të bonuseve nënshkrimit – nafta dhe gazi*Shumat në mijë Lek*

Pagesat në total	Raportimi fillestar	Mospërputhja e zgjidhur		Pa kundërparti	Shuma e korigjuar
		Paguesi	Arkëtuesi		
Të liçensuarit	390,634	(707)	-	-	389,927
AKBN	389,927	-	-	-	389,927
Mospërputhja	707	(707)	-	-	-

Vetëm 2 nga 5 të liçensuarit në kërkim raportuan pagesa të bonuseve të nënshkrimit. AKBN (Shteti) raportoi arkëtimin e bonuseve të nënshkrimit nga 2 të liçensuar në kërkim-zbulim.

Mospërputhja prej 707 mijë Lek rezultoi nga aplikimi i kurseve të ndryshme të këmbimit në raportim. Pagesat për bonuset e nënshkrimit janë paraqitur në USD.

Një pamje e detajuar e rakordimit për çdo shoqëri është paraqitur në Shtojcën 1.

6.2 Përmbledhja e rakordimit të flukseve të parasë në Buxhetin e Shtetit nga sektori mineral

Në total, u kërkuar raportim nga 69 shoqëri minerare për pagesat e kryera ndaj Buxhetit të Shtetit, përkatësisht 64 të liçensuar në prodhim dhe 6 të liçensuar në kërkim-zbulim. Beralb zotëronte liçensë në prodhim dhe kërkim-zbulim njëkohësisht.

Deri në datën e këtij Raporti, raportuan 65 nga 69 shoqëritë e përzgjedhura. Katër shoqëritë që nuk raportuan ishin Bytyçi Sh.p.k., Minex Sh.p.k., Mineral Invest Sh.p.k. and Kurti Sh.p.k.. Bazuar në raportimin e njëanshëm të institucioneve shtetërore për këto shoqëri, pagesat e tyre zinin 1.5% të fluksit total të parasë së raportuar nga sektori mineral.

Tabela më poshtë paraqet flukset e përmbledhura të parasë të raportuara nga shoqëritë në sektorin mineral.

Tabela 24 - Përmbledhja e rakordimit të pagesave nga sektori mineral në Buxhetin e Shtetit

Shumat në mijë Lek

Pagesat në total	Raportimi fillestar	Mospërputhja e zgjidhur		Pa kundërparti	Shuma e korigjuar
		Paguesi	Arkëtuesi		
Të liçensuarit	1,003,230	(9,964)	-	15,159	1,008,425
Qeveria	990,753	-	(1,931)	-	988,822
Mospërputhja	12,477	(9,964)	1,931	15,159	19,603

Shoqëritë e liçensuara raportuan fillimisht pagesa ndaj Shtetit në shumën 1,003,230 mijë Lek, të cilat ishin 12,477 mijë Lek më të larta se pagesat e raportuara nga Shteti.

Mospërputhjet prej 9,964 mijë Lek dhe 1,931 mijë Lek u shpjeguan nëpërmjet punës rakorduese. Një përmbledhje e flukseve dhe rakordimit është paraqitur më poshtë në rakordimin sipas llojit të të ardhurave.

Kolona "pa kundërparti", përfshin shuma të raportuara në mënyrë të njëanshme Shteti, për shoqëritë e përmendura më sipër që nuk raportuan deri në datën e këtij Raporti.

Një pamje e detajuar e rakordimit për çdo shoqëri është paraqitur në Shtojcën 2. Rakordimi i flukseve të parasë nga sektori mineral sipas llojit të të ardhurave paraqitet më poshtë:

Tabela 25 - Përmbledhja e rakordimit të pagesave nga sektori mineral në Buxhetin e Shtetit – sipas llojit të të ardhurave

Shumat në mijë Lek

Lloji i të radhurave	Shuma e paguesit	Shuma e arkëtuesit	Mospërputhja e zgjidhur		Mospërputhja e pazgjidhur	Pa kundërparti
			Paguesi	Arkëtuesi		
Tatimi mbi fitimin	555,518	532,143	(8,236)	(4,511)	20,843	1,195
Renta minerare - në eksport	337,479	343,845	(1,755)	-	(2,701)	5,417
Renta minerare - shitjet brenda vendit	92,450	95,962	346	2,580	(16)	5,731
Penaltitete tatimore	6,351	6,371	(320)	-	2,478	2,816
Tatimi mbi dividendin	11,429	12,432	-	-	(1,003)	-
Totali	1,003,227	990,753	(9,965)	(1,931)	19,601	15,159

Tatimi mbi firmimin dhe renta minerare përbëjnë përkatësisht 55% dhe 43% të fluksit të raportuar të parasë nga sektori mineral. Kontributi nga dy prodhuesit më të mëdhenj të kromit dhe të bakrit përbën 53% të flukseve totale të parasë së raportuar nga sektori mineral. Këto dy shoqëri ishin përkatësisht Beralb (bakër) me kontribut prej 464,092 mijë Lek ose 46% dhe Albchrome (krom) me kontribut prej 65,429 mijë Lek ose 7%.

Çështje të tjera të lidhura me raportimin

Në datën e këtij raporti, vetëm 48 nga 69 shoqëritë raportuese kanë dorëzuar raportimin dhe autorizimin e nënshkruar për publikim, përkrah raportimit elektronik. Tre Shoqëritë listuar më poshtë, refuzuan autorizimin për publikimin e pagesave të detajuara në këtë raport:

- Selenice Bitumi Sh.p.k
- Mineral Bitumen Sh.p.k.
- Xhireton Sh.p.k.

Për këtë arsye flukset e parasë deklaruar nga këto shoqëri janë raportuar në total. Shuma totale e deklaruar nga këto shoqëri përbën 2.1% të pagesave totale të raportuara nga sektori mineral.

6.2.1 Tatimi mbi fitimin – sektori mineral

Në vitin 2012, tatimi mbi fitimin përlogaritej 10% mbi fitimin e tatueshëm. Tatimi mbi fitimin mbliidhet nga Drejtoria Përgjithshme e Tatimeve.

Tabela 26- Përmbledhja e rakordimit të tatimit mbi fitimin për sektorin mineral

Shumat në mijë Lek

Pagesat në total	Raportimi fillestar	Mospërputhja e zgjidhur		Pa kundërparti	Shuma e korigjuar
		Paguesi	Arkëtuesi		
Të liçensuarit	555,518	(8,236)	-	1,195	548,477
Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve	532,143	-	(4,511)	-	527,632
Mospërputhja	23,375	-8,236	4,511	1,195	20,845

Në total, 53 nga 69 shoqëritë e liçensuara kanë raportuar pagesa për tatimit mbi fitimin, Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve raportoi arkëtime për 54 nga 69 të liçensuar. Bazuar në raportimin zyrtar të dorëzuar, u identifikuan mospërputhje në 18 raste. Nga këto, 8 raste u shpjeguan nëpërmjet punës së rakordimit. Arsytet dhe shpjegimet kryesore për mospërputhjet ishin:

- Pagesa të tatimit mbi fitimin u prezantuan të kompensuara (neto) me tepricë kreditore të TVSH-së, duke rezultuar në shuma më të vogla ose zero.
- Shuma të padeklaruara nga autoritetet tatimore. Këto pagesa janë raportuar nga Shoqëritë e liçensuara dhe mbështetur me dokumenta pagese ku tregohet se Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve ishte përfituesi i parave.
- Në disa raste shoqëritë e liçensuara gabimisht nuk raportuan disa pagesa, të cilat ishin deklaruar nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve.

Pagesat “pa kundërparti” përfshijnë deklarinimin e njëanshëm e shumës prej 1,195 mijë Lek, të raportuar nga Shteti për Bytyçi Sh.p.k.

Ka ende 11 raste mospërputhjes të pazgjidhura deri në datën e këtij raporti. Në 4 raste shoqëritë e liçensuara raportuan 23,669 mijë Lek më shumë se Shteti. Në 7 raste Shteti raportoi 2,826 mijë Lek pagesa më shumë se Shoqëritë e liçensuara. Mospërputhjet neto janë 20,843 mijë Lek.

Një pamje e detajuar e rakordimit për çdo shoqëri është paraqitur në Shtojcën 2.

6.2.2 Renta minerare –sektori mineral

Renta minerare aplikohet me një normë tatimore që varion 4-7% të vlerës së tatueshme (ose vlerës fiskale) të të ardhurave nga shitja e mineraleve të nxjerra. Renta minerare për eksportet mbliidhet nga Administrata Doganore Shqiptare, ndërsa renta minerare për shitjet brenda vendit mbliidhet nga Drejtoria e Përgjithshme Tatimeve.

Tabela 27 - Përmbledhja e rakordimit të rentës minerare për eksportet - sektori mineral

Shumat në mijë Lek

Pagesat në total	Raportimi fillestar	Mospërputhja e zgjidhur		Pa kundërparti	Shuma e korigjuar
		Paguesi	Arkëtuesi		
Të liçensuarit	337,479	(1,755)	-	5,417	341,141
Administrata Doganore Shqiptare	343,845	-	-	-	343,845
Mospërputhja	(6,366)	(1,755)	-	5,417	(2,704)

Në total, 49 nga 64 prodhues raportuan rentë minerare paguar për eksportet, ndërsa Autoriteti doganor raportoi arkëtime për 52 nga 64 të liçensuar në prodhim. Bazuar në raportimin zyrtar të dorëzuar, u identifikuan mospërputhje në 39 raste, nga të cilat 29 u shpjeguan nëpërmjet punës rakorduese. Arsytet dhe shpjegimet kryesore për mospërputhjet ishin si më poshtë:

- Ndryshe nga udhëzimet, pothuajse të gjitha Shoqëritë e liçensuara raportuan parapagimet në Doganë, në vend të rentës minerare të paguar gjatë vitit.
- Në pak raste të liçensuarit dhe institucionet shtetërore lanë gabimisht jashtë raportimit ose klasifikuan në mënyrë jo të saktë pagesat e tyre fillestare.

Ka ende 10 mospërputhje të pazgjidhura deri në datën e këtij raporti. Në 3 raste, të liçensuarit raportuan pagesa më të mëdha se Shteti për 715 mijë Lek. Në 8 raste Shteti raportoi pagesa më të mëdha se të liçensuarit prej 3,419 mijë Lek. Mospërputhjet neto janë 2,704 mijë Lek.

Në kolonën “pa kundërparti” është përfshirë deklarimi i njëanshëm nga Autoriteti doganor për shumën 5,417 mijë Lek të paguar nga Bytyçi Sh.p.k., Mineral Invest Sh.p.k. dhe Kurti Sh.p.k. Një pamje e detajuar e rakordimit për çdo shoqëri është paraqitur në Shtojcën 2.

6.2.2 Renta minerare –sektori minerar (vazhdim)

Tabela 28 - Përmbledhja e rakordimit të rentës minerare nga sektori minerar – shitjet brenda vendit

Shumat në mijë Lek

Pagesat në total	Raportimi fillestar	Mospërputhja e zgjidhur		Pa kundërparti	Shuma e korigjuar
		Paguesi	Arkëtuesi		
Të liçensuarit	92,450	346	-	5,731	98,527
Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve	95,962	-	2,580	-	98,542
Mospërputhja	(3,512)	346	(2,580)	5,731	(15)

Në total, 34 nga 64 prodhues raportuan pagesa të rentës minerare për shitjet brenda vendit, ndërsa Autoriteti tatimor raportoi arkëtime për 36 nga 64 të liçensuar. Bazuar në raportimin zyrtar të dorëzuar, u identifikuan mospërputhje në 17 raste. Nga këto mospërputhje, 6 u shpjeguan nëpërmjet punës rakorduese. Arsyet dhe shpjegimet kryesore për mospërputhjet ishin si më poshtë:

- Të liçensuarit dhe autoritetet tatimore raportuan gjoba, të cilat nuk janë përfshirë në rakordim.
- Të liçensuarit fillimisht nuk raportuan pagesa të cilat ishin deklaruar nga autoritetet tatimore. Kur u kontaktuan, ata pranuan se pagesat ishin kryer ndaj autoriteteve tatimore.

Ka ende 11 mospërputhje të pazgjidhura deri në datën e këtij raporti. Në 7 raste të liçensuarit raportuan pagesa më të mëdha se Shteti për 1,567 mijë Lek. Në 3 raste Shteti raportoi pagesa më të mëdha se të Liçensuarit prej 1,584 mijë Lek. Mospërputhjet neto janë 15 mijë Lek.

Në kolonën “pa kundërparti” është përfshirë deklarimi i njëanshëm nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve për shumën 5,731 mijë Lek paguar nga Bytyçi Sh.p.k. and Mineral Invest Sh.p.k.

Një pamje e detajuar e rakordimit për çdo shoqëri është paraqitur në Shtojcën 2.

6.2.3 Penalitetet tatimore – sektori minerar

Këtë vit, u kërkua që të liçensuarit të raportonin pagesat për penalitetet tatimore të paguara në lidhje me taksat dhe tarifat e përfshira në këtë rakordim.

Tabela 29 - Përmbledhje e rakordimit të penaliteteve tatimore - sektori minerar

Shumat në mijë Lek

Pagesat në total	Raportimi fillestar	Mospërputhja e zgjidhur		Pa kundërparti	Shuma e korigjuar
		Paguesi	Arkëtuesi		
Të liçensuarit	6,351	(320)	-	2,816	8,847
Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve	6,371	-	-	-	6,371
Mospërputhja	(20)	(320)	-	2,816	2,476

Nga 69 shoqëri raportuese vetëm 16 raportuan penalitete tatimore. Sipas raportimit zyrtar u identifikuan mospërputhjes në 12 raste. Nga këto, 5 u shpjeguan nëpërmjet punës së rakordimit. Arsyet kryesore dhe sqarimet për mospërputhjet ishin si më poshtë:

- Të liçensuarit raportuan penalitete të lidhura me TVSH e cila nuk është përfshirë në këtë rakordim;
- Të liçensuarit raportuan penalitete të lidhura me taksat vendore të cila nuk janë përfshirë në këtë rakordim.

Ka ende 7 mospërputhje të pazgjidhura në datën e këtij raporti. Në 5 raste të liçensuarit raportuan pagesa më të mëdha se Shteti për 2,507 mijë Lek. Në 2 raste Shteti raportoi pagesa më të mëdha se të liçensuarit prej 29 mijë Lek. Mospërputhjet neto janë 2,476 mijë Lek.

Një pamje e detajuar për çdo shoqëri është paraqitur në Shtojcën 2.

Në kolonën “pa kundërparti” është përfshirë deklarimi i njëanshëm nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve për shumën 2,816 mijë Lek paguar nga Bytyçi Sh.p.k. and Kurti Sh.p.k.

6.2.4 Tatimi mbi dividendin – sektori minerar

Përkrah penaliteteve tatimore, të liçensuarit duhet të raportojnë edhe tatimin mbi dividendin.

Tabela 30 - Përmbledhja e rakordimit të tatimit mbi dividendin nga sektori minerar

Shumat në mijë Lek

Pagesat në total	Raportimi fillestar	Mospërputhja e zgjidhur		Pa kundërparti	Shuma e korigjuar
		Paguesi	Arkëtuesi		
Të liçensuarit	11,429	-	-	-	11,429
Drejtorja e Përgjithshme e Tatimeve	12,432	-	-	-	12,432
Mospërputhja	(1,003)	-	-	-	1,003

Në total, 5 të liçensuar kanë raportuar tatim të paguar mbi dividendin. Mospërputhje pati vetëm në një rast kur i liçensuari nuk konfirmoi pagesën e deklaruar nga Drejtorja e Përgjithshme e Tatimeve.

Një pamje e detajuar e rakordimit për çdo shoqëri është paraqitur në Shtojcën 2.

6.2.5 Përmbledhje e rasteve të paraportuara nga Shteti

Më poshtë paraqitet një përmbledhje e mospërputhjeve që duhet të hetohen më tej nga strukturat raportuese shtetërore:

Tabela 31 – Raste që duhen hetuar më tej nga strukturat raportuese shtetërore

Shumat në mijë Lek

Të liçensuarit	Shuma e paguesi	Shuma e arkëtuesi	Mospërputhja e zgjidhur		Mospërputhja e pazgjidhur	Pa kundërparti	Komente
			Paguesi	Arkëtuesi			
Renta minerare paguar Autoritetit tatimor për shitjet brenda vendit							
Ral Sh.p.k.	406	-	-	-	-	-	Shuma nuk është deklaruar nga tatimet
“Ylberi” Sh.p.k.	208	-	-	-	-	-	Shuma nuk është deklaruar nga tatimet
Egi - K Sh.p.k.	5,097,566	2,773,926	2,323,640	-	-	-	Shumë e padeklaruar nga tatimet, mbështetur me dokument pagese nga - Shoqëria
Alb - Canaj Sh.p.k.	165,103	119,224	45,879	-	-	-	Shumë e padeklaruar nga tatimet, mbështetur me dokument pagese nga - Shoqëria
Stone Production Sh.p.k.	3,600,645	3,408,417	192,228	-	-	-	Shumë e padeklaruar nga tatimet, mbështetur me dokument pagese nga - Shoqëria
Renta minerare paguar Autoritetit doganor për eksportet							
Prodhime Karbonike Sh.a.	161	-	-	-	-	-	Shumë e padeklaruar nga dogana, mbështetur me dokument pagese nga 161 Shoqëria.
Tatimi mbi fitimin paguar Autoritetit tatimor							
Koka Sh.p.k.	2,417,603	3,209,603	(792,000)	-	-	-	Shumë e padeklaruar nga tatimet, mbështetur me dokument pagese nga - Shoqëria
Zasha Sh.p.k.	3,921,300	3,735,423	185,877	-	-	-	Shumë e padeklaruar nga tatimet, mbështetur me dokument pagese nga - Shoqëria
KNAUF - Tirana Sh.p.k.	571,097	405,402	165,695	-	-	-	Shumë e padeklaruar nga tatimet, mbështetur me dokument pagese nga - Shoqëria
Nika BL Sh.p.k.	890	-	-	-	-	-	Shumë e padeklaruar nga 890 tatimet
Tili Inert Sh.p.k.	1,284	-	-	-	-	-	Shumë e padeklaruar nga 1,284 tatimet

6.3 Rakordimi i pagesave të arkëtuara nga Albpetrol

Albpetrol mbajti pjesë nga prodhimi i gjeneruar nga këto marrëveshjet hidrokarbure nën administrimin e tij. Të liçensuarit and Albpetrol reportuan pagesate e mëposhtme për ndarjen e prodhimit të naftës në vitin 2012:

Tabela 32 - Përmbledhja e rakordimit të pagesave nga sektori i naftës dhe gazit për pjesën nga ndarja e prodhimit- mbledhur nga Albpetrol

Shumat në mijë Lek

Të liçensuarit	Shuma e paguar nga i liçensuari	Sasia paguar nga i liçensuari (në ton)	Shuma e arkëtuar nga Albpetrol	Sasia arkëtuar nga Albpetrol (në ton)	Mospërputhja e zgjidhur		Mospërputhja e pazgjidhur	Komente
					Paguesi	Arkëtuesi		
Bankers Petroleum Albania L.t.d.	4,226,543	84,197	3,956,260	84,202	-	270,283	-	Diferenca prej 5 ton rezulton nga konvertimi i barrelave në ton. Albpetrol ka përdorur një çmim të ndryshëm nga çmimi i transferimit. Kjo shkakton diferencën në Lek.
Dega në Shqipëri e Stream Oil & Gas L.t.d.	1,094,944	23,304	1,094,944	23,304	-	(1)	-	
Sherwood International Petroleum L.t.d.	9,287	158	7,301	155	-	1,986	-	Diferenca prej 3 ton rezulton nga konvertimi i barrelave në ton. Albpetrol ka përdorur një çmim të ndryshëm nga çmimi i transferimit. Kjo shkakton diferencën në Lek.
Transoil Group - Dega në Shqipëri	147,722	3,144	84,264	1,793	-	-	63,458	Diferenca për 1,351 ton
Totali	5,478,496	111,705	5,142,769	109,455	-	272,268	-	

Në vitin 2012 Albpetrol ka arkëtuar një bonus nënshkrimi prej 300,000 USD nga Emanuelle Adriatic Energy Limited. Në 2011 nuk është arkëtuar bonus nënshkrimi nga Albpetrol.

Tabela 33 - Përmbledhje e flukseve të parasë nga sektori hidrokarbur për bonuset e nënshkrimit – arkëtuar nga Albpetrol

Shumat në mijë Lek

Të liçensuarit	Shuma e paguar nga i liçensuari	Shuma e arkëtuar nga Albpetrol	Mospërputhja e zgjidhur		Mospërputhja e pazgjidhur	Pa kundërparti	Komente
			Paguesi	Arkëtuesi			
Emanuelle Adriatic Energy Limited	31,701	31,701	-	-	-	-	
Totali	31,701	31,701	-	-	-	-	

6.4 Rakordimi i pagesave kryer nga Albpetrol në Buxhetin e Shtetit

Në 2012, Albpetrol kontribuoi në Buxhetin e Shtetit si më poshtë:

Tabela 34 - Përmbledhje e flukseve të parasë paguar nga Albpetrol

Shumat në mijë Lek

Lloji i të ardhurave	Sum of Albpetrol	Sum of Government	Mospërputhja e zgjidhur		Mospërputhja e pazgjidhur	Komente
			Paguesi	Arkëtuesi		
Renta minerare – shitjet brenda vendit	742,637	735,622	-	-	7,015	
Renta minerare – eksportet	235,000	231,624	(3,376)	-	-	Shoqëria ka raportuar parapagimet në Doganë
Tatimi mbi fitimin	561,234	172,231	389,003	-	-	Albpetrol raportoi penalitetet bashkë me tatimin mbi fitimin
Penalitetet tatimore	-	434,030	(389,003)	-	45,027	Penalitetet raportuar bashkë me tatimin mbi fitimin më sipër
Dividenti i paguar në shtet	99,951	99,951	-	-	-	
Dividenti i paguar në Shtet – <i>Tatimi mbi dividendin</i>	253,296	227,916	-	-	(25,379)	
Totali	1,892,118	1,901,374	(3,376)	-	(12,633)	

Deri në datën e këtij Raporti, ne nuk morëm shpjegim për mospërputhjen prej 12,633 mijë Lek.

7. Komente dhe rekomandime

Raporti EITI 2012 u përfundua në nëntor 2014. Ky është viti i katërt që shoqëritë e liçensuara dhe institucionet qeveritare në Shqipëri raportojnë pagesat lidhur me aktivitetin hidrokarbur dhe minerar, mbi bazën e parimeve EITI. Raporti i parë u përfundua në vitin 2011 për pagesat e kryera në 2009.

Gjatë rrjedhës së këtij angazhimi, ne identifikuam dhe përmblodhëm si më poshtë aspekte që mund të përmirësohen më tej, që ndikojnë në shtrirjen e raportimit EITI dhe vetë procesin. Përcaktimi i prioritetëve relative dhe kohës së zbatimit të rekomandimeve të pranuar është përgjegjësi e Grupit Shqiptar të Punës.

7.1 Forcimi i aksesit në të dhëna cilësore dhe të besueshme

Në zbatim të rekomandimeve të administratorit të mëparshëm për raportin EITI 2010, me qëllim forcimin e aksesit në të dhëna të besueshme brenda afatit të raportimit, Grupi Shqiptar i Punës caktoi pika kontakti kordinues për procesin EITI në çdo institucion qeveritar raportues përfshirë MEI-n, AKBN-në, Shërbimin Gjeologjik Shqiptar, Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve, Administratën Doganore Shqiptare etj, si dhe shoqëritë e mëdha që operojnë në sektorin hidrokarbur dhe atë minerar.

Panëvarësisht nga ky fakt, gjatë rakordimit për vitin 2011 dhe 2012 ne vumë re një sërë barrierash që penguan aksesin në kohë të të dhënave të plota dhe të besueshme. Disa nga këto pengesa dhe sugjerime për përmirësim përshkruhen në pikat e mëposhtme:

7.1.1 Kuadri regullator për raportimin EITI

Rregullimi i raportimit EITI për sektorin minerar adresohet nga Ligji Minerar dhe VKM nr. 233 datë 23 mars 2011. Shoqëritë në sektorin hidrokarbur kanë pranuar vullnetarisht bashkëpunimin për raportimin EITI nëpërmjet nënshkrimit të memorandumit të mirëkuptimit. Në zbatim të kërkesave të reja të Standartit EITI dhe rekomandimeve në raportin EITI 2011, në tetor 2014 Qeveria Shqiptare ndryshoi Ligjin Minerar. Ndryshimet në ligj i dhanë të drejtë Sekretariatit EITI në Shqipëri të mbledhë dhe të publikojë në raportin EITI informacion për taksat e paguara shoqëritë minerare dhe institucionet qeveritare arkëtuese përfshirë autoritetet tatimore e doganore dhe njësitë e qeverisjes vendore.

Ne kuptojmë që kërkesa për raportim nga ana e institucioneve qeveritare aktualisht është në konflikt me detyrimin e tyre ligjor për të ruajtur konfidencialitetin mbi informacionin e marrë gjatë punës së tyre. Këto dispozita konfidencialiteti, të referuara në ligjet e aplikueshme për procedurat tatimore dhe doganore në Shqipëri¹⁷, lejojnë akses në të dhënat vetëm me pëlqimin e shprehur nga shoqëritë e liçensuara. Institucionet qeveritare mund të shkëmbejnë të dhëna sipas disa kushteve strikte konfidencialiteti.

Rekomandime

Në këto kushte ne rekomandojmë që për publikimin e të dhënave të detajuara për çdo shoqëri MSG dhe AlbEITI të marrin konfirmimin për publikim për çdo raportim të dorëzuar nga shoqëritë. Ky konfirmim duhet të autorizojë institucionet qeveritare arkëtuese të paraqesin informacionin për shoqëritë përkatëse në kuadrin e raportimit EITI. Ky rekomandim vlen edhe për shoqëritë raportuese në sektorin e naftës dhe gazit, të cilat kanë pranuar vullnetarisht të bashkëpunojnë për raportimin EITI nëpërmjet nënshkrimit të marrëveshjeve të mirëkuptimit.

Statusi aktual

Deri në datën e këtij raporti në marrëveshje autorizim për publikim me shkrim për 55 nga 78 shoqëri raportuese. Nga 78 shoqëri raportuese, 3 refuzuan shprehimisht autorizimin, nërsa 19 shoqëri raportuese pranuan verbalisht, por nuk arritën të dorëzonin autorizimin e nënshkruar deri në datën e këtij Raporti.

¹⁷ Ligji Nr. 9920, datë 19 maj 2008 "Mbi procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë, i ndryshuar" dhe Ligji Nr. 8449, datë 27 janar 1999 "Për Kodin Doganor në Republikën e Shqipërisë, i ndryshuar".

7.1.2 Akses në të dhëna të besueshme dhe në kohë nga Shteti

Caktimi i pikave kryesore EITI ndërmjet institucioneve shtetërore, ndikon pozitivisht në rritjen e ndërgjegjësimit dhe koordinimit të aktiviteteve EITI. Megjithatë, përpjekje të mëtejshme duhet të bëhen për të përmirësuar raportimin dhe analizat e aktivitetit të industrisë nxjerrëse dhe flukseve të parasë.

a) Forcimi i aksesit në të dhëna të besueshme dhe në kohë

